



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 81 regjistër (JR)
Datë 20.12.2021

Nr. 57 i vendimit
Datë 13.11.2024

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë në dhomë këshillimi, më datë 13.11.2024, ditën e mërkurë, në orën 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Arjela Vllaçaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Ajola Prençi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 470, datë 01.11.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 4, 15, 17, 18, 30, 42, 53, 54 dhe 179/b, pika 2 e 5; Aneksi i Kushtetutës, nenet A, Ç, D, Dh dhe F; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenet 1, 6, 8, 12 dhe 14; protokoli nr. 12, neni 1; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 62-66; ligji nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës

së Shqipërisë”, nenet 4, 12, 13, 14 dhe 17; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nenet 47 dhe 51; Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës e Asamblesë së OKB-së, datë 02.11.1989; Kodi i Familjes, nenet 1, 2, 3, 5 dhe 215; si dhe ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, nenet 2, 3, 3, 6 dhe 9.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shkaqet e ankimit dhe pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në materialin “Shkaqe shtesë ankimi/parashtrim hyrës”, me të cilat kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 470, datë 01.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e saj në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ajola Prençi (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të funksionit prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, në bazë të nenit 179/b të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin e vetëvlerësimit profesional.
3. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e dërguara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).
 - 3.1. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, e cila ka qenë subjekt deklarues nga viti 2003, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë

dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklaram të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave¹.

3.2. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, sipas parashikimeve të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, ka dërguar pranë Komisionit raportin ku ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit².

3.3. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit³.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Ajola Prençi, bazuar në tri kriteret e vlerësimit. Me vendimin nr. 470, datë 01.11.2021, Komisioni vendosi shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra. Referuar Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriteret e rivlerësimit, Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit:
 - a) *Nuk ka arritur nivel të besueshëm, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016, sa i takon kriterit të pasurisë;*
 - b) *Për kriterin e kontrollit të figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka kontakte me person të përfshirë në krimin e organizuar, dhe që e bën të pamundur vazhdimin e detyrës;*
 - c) *[...] subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr.84/2016 dhe, për këtë shkak, konsiderohet “i aftë”.*
 - d) *Në vlerësimin tërësor të problematikave të analizuara më lart, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, duke u gjendur në kushtet e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.*

III. Shkaqet e ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit ushtroi ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”)⁴, kundër vendimit të sipër përmbledhur, me pretendimin se duke vlerësuar të gjithë rrethanat, aplikimi i nenit 61, pikat 2, 3 dh 5 të ligjit nr. 84/2016, është tërësisht i kundërligjshëm. Subjekti i rivlerësimit kërkoi marrjen në cilësinë e provave të reja të disa akteve shkresore paraqitur

¹ Me nr. {***} prot., datë 21. 01.2019.

² Me nr. {***} prot., datë 30.10.2017, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 07.07.2020, të KDZh-së. Pas kërkesës së Komisionit, DSIK-ja ka dërguar raportin e përditësuar nr. {***} prot., datë 01.07.2021, të deklasifikuar pjesërisht me vendim nr. {***}, datë 16.09.2021, të KDZh-së.

³ Me nr. {***} prot., datë 12.02.2019.

⁴ Ankimi është depozituar në Komision me nr. {***}, datë 13.12.2021, brenda afatit ligjor.

bashkëlidhur ankimit, si dhe pyetjen e dy shtetasve në cilësinë e dëshmitarëve⁵. Përmes ankimit, subjekti ka kërkuar që Kolegji të vendosë:

- (i) *Kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë publike;*
- (ii) *Marrjen dhe administrimin e provave bashkëngjitur ankimit, provave të kërkuara në ankim, si dhe provave të reja që mund të dalin pas dhënies së vendimit të KPK-së nr. 470/2021;*
- (iii) *Ndryshimi i vendimit nr. 470, datë 01.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;*
- (iv) *Konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit, znj. Ajola Prençi, prokurore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.*

6. Përpos këtyre kërtimeve, më datë 17.10.2024, subjekti paraqiti në Kolegj *shkaqe shtesë ankimi/parashtrim hyrës*, si dhe disa akte bashkëlidhur⁶. Duke theksuar se i qëndron të gjithë shkaqeve të ankimit, subjekti shprehet se meqenëse nga koha e depozitimit të ankimit është njohur

⁵ Subjekti kërkoj të administrohen si prova aktet bashkëlidhur ankimit:

- (i) *Memo e datës 21.02.2014, drejtuar prokurorit N. T.;*
- (ii) *Ankim i datës 28.02.2014, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm;*
- (iii) *Kërkesë për pavlefshmëri absolute/relative, papërdorshmëri të akteve dhe veprimeve hetimore, e datës 17.09.2015;*
- (iv) *Parashtrim hyrës i datës 09.10.2015, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër;*
- (v) *Konkluzione për procedimin penal nr. {***}/2013, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër;*
- (vi) *Apelim kundër vendimit nr. {***}, datë 04.12.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër;*
- (vii) *Apelim shtesë kundër vendimit nr. {***}, datë 04.12.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër;*
- (viii) *Parashtrim hyrës i datës 23.09.2016, drejtuar Gjykatës së Apelit Shkodër;*
 - Subjekti kërkoj të merren dhe të administrohen si prova:
 - (i) *Të pyeten në cilësinë e dëshmitarëve shtetasit L. e Xh. Th.;*
 - (ii) *Dosja penale e bashkëshortit P. P. nga Gjykata e Lartë;*
 - (iii) *Rekurs i datës 21.10.2016 drejtuar Gjykatës së Lartë.*

⁶ Bashkëlidhur dokumentit “Shkaqe shtesë ankimi/parashtrim hyrës”, administruar në Kolegj, me nr. {***} prot., datë 17.10.2024, subjekti ka depozituar:

- (i) *Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme nr. {***}, datë 11.12.2000, me palë shitëse Xh. Th. dhe palë blerëse F. Th. dhe S. B. dhe F. B., marrë me aktin “Vërtetim i njësisë me origjinalin”, me nr. {***} rep., datë 18.05.2023;*
- (ii) *Shkresë [kthim përgjigje] me nr. {***} prot., datë 17.05.2023, e ASHK-së, Drejtoria Vendore Shkodër;*
- (iii) *Shkresë [kthim përgjigje] me nr. {***} prot., datë 28.04.2023, e Komisionit;*
- (iv) *Printim i Studimit “Household Economies of Scale in Consumption: Theory and Evidence” të Julie A.Nelson [https://www.jstor.org/stable/1913099];*
- (v) *Printim i studimit “Urbanizimi dhe ekonomia, rasti studimor: Shqipëria” botuar në Gazetën Mapo, datë 22.11.2017 [Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare Ditët e Studimeve Shqiptare organizuar nga UET];*
- (vi) *Printim i publikimit të datës 17.07.2023, në adresën: <http://www.monitor.al/eurostat-shqipëria-me-varfërinë-dhe-pabarazinë-me-te-larte-qytet-fshat-ne-europe>; <http://www.panorama.com.al/eurostat-publikon-të-dhenat-shqipëria-me-varfërinë-dhe-pabarazinë-me-te-larte-qytet-fshat-ne-europe/>.*
- (vii) *Shkresë [kthim përgjigje] me nr. {***} prot., datë 26.08.2024, e DRT-së Shkodër;*
- (viii) *Shkresë [kthim përgjigje] me nr. {***} prot., datë 10.05.2023, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;*
- (ix) *Vendim nr. {***}, datë 18.07.2024, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Dhoma Penale;*
- (x) *Vendim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. {***} prot., datë 17.06.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit A. Y.;*
- (xi) *Vërtetim i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, datë 16.10.2024 [për punësimin e bashkëshortit P. P.];*
- (xii) *Vërtetim i gjendjes gjyqësore të shtetasit P. P., nr. kërkesë {***}, datë 16.10.2024.*

me rrethana të reja – *prova dhe vendimmarrje të Kolegjit që përbëjnë praktikë të konsoliduar* – objektivisht të pamundura t'i njihte gjatë procesit administrativ në Komision dhe në kohën e ushtrimit të ankimit, bazuar në nenin 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” [në vijim “ligji nr. 49/2012”], paraqet shkaqe ankimi dhe prova shtesë, të cilat kërkon të bëhen pjesë e shqyrtimit dhe vlerësimit nga Kolegji, bashkëlidhur me ankimin dhe provat e paraqitura me të.

7. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, të cilat kanë natyrë procedurale dhe i adresohen procesit të rregullt ligjor, si dhe ato që lidhen me themelin, në kundërshtim të konkluzioneve Komisionit, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si vijon.

7.1. Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale: Subjekti i rivlerësimit pretendon për mosrespektim të procedurës në rivlerësimin kalimtar të saj, në shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor, të objektivitetit, proporcionalitetit, ligjshmërisë, barazisë, mosdiskriminimit, gjësë së gjykuar dhe gjykimit dy herë për të njëjtin fakt, si dhe të humanizmit.

7.2. Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e pasurisë: Subjekti i rivlerësimit ankimon konkluzionet e Komisionit, lidhur me një apartament në Shkodër, analizën financiare për vitet 2011, 2012 dhe 2016, dhe konkretisht:

*7.2.1. Lidhur me pasurisë apartament me sipërfaqe 75 m², në adresën Bulevardi “{***}”, lagjja “{***}”, pallati {***}, kati i {***}, Shkodër, rrethanat e shpjeguara prej saj nuk janë vlerësuar në unitet, bazuar në parimin e barazisë, objektivitetit, humanizmit dhe proporcionalitetit.* Mosdeklarimi në DIPP-në 2004 dhe në deklaratën *vetting* i huas, si burim fillestar i krijimit të pasurisë, është pasaktësi që nuk mund të konsiderohet si pamjaftueshmëri në deklaram, përderisa marrja e huas është bërë me akt noterial në kohë me fuqi të plotë provuese, e provohet se nuk ekzistojnë element keqbesimi për të fshehur burimet e krijimit të pasurisë. Me aktet shkresore ka provuar se huadhënësit/bashkëshortët Th. kanë pasur burime të ligjshme për të dhënë huan prej 1.500.000 lekësh. Në analizën financiare të vitit 2004, duhet të përfshihet kjo hua, si burim i ligjshëm, si edhe kursimet *cash* të bashkëshortit në vlerën 1.000.000 lekë, të padeklaruara në DIPP-në 2003, për shkak të gabimit të tij në plotësimin e deklaratës.

7.2.2. Lidhur me analizën financiare për vitet 2011 dhe 2012: (i) duhet të njihen si të ardhura pjesa e mbetur nga bonusi i transportit marrë nga bashkëshorti, sipas ekspertimit auto-teknik të paraqitur, mendim shkencor që prevalon përballë çdo prezumimi siç është dhe praktika e Kolegjit, që nuk i ka përfshirë në analizën financiare, duke i konsideruar të shpenzuara për transport; *(ii)* për të shmangur përllogaritjen dy herë të shpenzimeve të transportit, me pasojë rritjen e këtyre shpenzimeve ose duhet të njihen si të ardhura të ligjshme dietat e bashkëshortit ose këto shpenzime, në vlerën e dietave të zbriten në shpenzimet për jetesë, sipas standardeve të ILDKPKI-së dhe INSTAT-it.

7.2.3. Lidhur me analizën financiare për vitin 2016, duhet të merren në konsideratë argumentet e saj tërësisht ligjore, por edhe logjike se në deklaram në shpenzimet e përgjithshme të familjes janë

përfshirë shpenzimet e bashkëshortit nga avokatia, të cilat nuk janë specifikuar, pasi kanë qenë në vlerë më të vogël se kufiri i parashikuar në ligj për deklarim. Gjithashtu, lidhur me analizën financiare të viteve 2011, 2012 dhe 2016, për llogaritjen e shpenzimeve për jetesë, subjekti kërkon marrjen në konsideratë të argumenteve të paraqitura në parashtrime lidhur me shpenzimet për jetesë të familjes Th.

7.3. Shkaqet e ankimit lidhur me kontrollin e figurës dhe vlerësimin tërësor: Subjekti i rivlerësimit pretendon se vlerësimi *si e papërshtatshme për vazhdimin e detyrës* pa asnjë të dhënë objektive në lidhje me të, por vetëm për shkak të lidhjes martesore me shtetasin P. P. dhe të vendimit gjyqësor në ngarkim të tij, përderisa nuk ka asnjë parashikim që detyron vënien në balancë të familjes me profesionin, është antikushtetues dhe rrjedhojë e interpretimit tërësisht të gabuar të ligjit nr. 84/2016. Sipas subjektit, konkluzioni i Komisionit se subjekti gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut, të parashikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, është i pabazuar ligjërisht.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

i. Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimimi i ankueses

9. Ankuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.
10. Në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), lidhur me çështjen objekt shqyrtimi, rezulton se është paraqitur një kërkesë e z. A. Y., vëllai i subjektit, gjithashtu edhe ai subjekt rivlerësimi, me objekt: (i) legjitimimin e tij si person i tretë (ndërhyrës dytësor vullnetar), sipas nenit 191 të Kodit të Procedurës Civile⁷; (ii) kalimin e çështjes nr. 81/2021 (JR), për shqyrtim në

⁷ “Kushdo mund të ndërhyjë në një proces gjyqësor që zhvillohet ndërmjet personave të tjerë, kur ka interes për të mbështetur njërin ose tjetrën palë, me të cilën bashkohet në gjykim për ta ndihmuar atë”.

seancë gjyqësore publike, në prani të palëve - edhe me pjesëmarrjen e tij si person i tretë - bazuar në ligjin nr. 49/2012, i ndryshuar, nenin 6 paragrafi 2, nenin 8, paragrafët 1 dhe 2 të KEDNj-së; (iii) dhënie dëshmie vullnetare, lidhur me përgjegjësinë që ka subjekti i rivlerësimit, znj. Ajola Prençi (Ymeri), në lidhje me vazhdimin e marrëdhënies së saj martesore me shtetasin P. P.

11. Trupi gjykues mori në shqyrtim kërkesën e sipërpërmendur, duke konkluduar se ajo duhej të rrëzohej si e pambështetur në ligj. Neni 191 i Kodit të Procedurës Civile, i përmendur si bazë ligjore prej kërkuarit A. Y., u vlerësua si i pazbatueshëm në rastin konkret, qoftë në pikëpamje të parashikimeve ligjore, qoftë në konsideratë të rrethanave të faktit.

11.1. Së pari, trupi gjykues sjell në vëmendje se procesi i rivlerësimit është një proces i jashtëzakonshëm kushtetues, i cili mbështetet në dispozitat e posaçme kushtetuese të miratuara për zhvillimin e tij, në nenin 179/b të Kushtetutës ato të Aneksit të Kushtetutës, si edhe dispozitat e ligjit nr. 84/2016. Ky proces është parashikuar të zhvillohet për çdo individ që ushtron funksionin e prokurorit dhe gjyqtarit në momentin e hyrjes në fuqi të kuadrit ligjor të miratuar me ligjin nr. 76/2016, të cilët do t'i nënshtrohen një kontrolli të plotë lidhur me tri kriteret e rivlerësimit, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Kolegji ka konsoliduar tashmë qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e tij se ky proces është individual dhe i pavarur për secilin individ dhe vlerësimi i rrethanave të secilës çështje do të duhet të kryhen në përputhje me specifikat e secilit rast, po ashtu në mënyrë të pavarur, edhe zbatimi i parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit. Në këtë kuptim, asnjë konkluzion i marrë në këtë çështje, për subjektin e rivlerësimit, znj. Ajola Prençi, nuk mund të afektojë drejtpërdrejtë procesin e rivlerësimit të vëllait të saj, kërkuarit A. Y., dhe veçanërisht mënyrën e përfundimit të tij.

11.2. Thirrja për zbatim e nenit 192 të Kodit të Procedurës Civile vlerësohet nga trupi gjykues se nuk vjen në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, i cili lejon thirrjen për zbatim të dispozitave procedurale civile për atë që janë të zbatueshme. Natyra e procesit civil, me kontradiktoritetin që e shoqëron, ka përcaktuar edhe nevojën për garantimin e të drejtave të personave të tretë për të marrë pjesë në gjykime, kur e drejta në konflikt mes palëve ndërgjyqëse mund t'i përkasë/interesojë edhe atij. Në procesin e rivlerësimit, vendimi për karrierën e magjistratit, si një formë e sanksionit disiplinor, shtrin efektet vetëm ndaj atij magjistrati dhe jo ndaj familjarëve të tij, atë më tepër kur kërkuari, gjithashtu, është subjekt rivlerësimi dhe i nënshtrohet drejtpërdrejtë kontrollit prej organeve të rivlerësimit.

11.3. Për sa i përket kërkesave të tjera të kërkuarit A. Y., lidhur me kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike apo vetëofrimin e tij për t'u pyetur si dëshmitar, trupi gjykues i gjen atë krejtësisht pa relevancë dhe kërkuarin në mungesë të plotë legjitimiteti për paraqitjen e tyre. Dispozitat procedurale përcaktojnë se të drejtën për kërkime të tilla e kanë vetëm palët e një procesi ose gjykata kryesisht kur ajo e çmon të nevojshme. Në këto rrethana, trupi gjykues, në zbatim të nenit 194 të Kodit të Procedurës Civile, vendosi të refuzojë kërkesën e kërkuarit A. Y. si të pabazuar në ligj.

iii. Forma e gjykimit

12. *Lidhur me kërkesat e subjektit për marrjen e provave të reja.* Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit të subjektit të rivlerësimit kundër vendimit të Komisionit, si rregull, kryhet në dhomën e këshillimit. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi u mor në shqyrtim nga trupi gjykues në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi. Trup gjykues shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, si dhe për të pranuar aktet e sjella në cilësinë e provave të reja. Në analizë të rrethanave që rezultojnë nga çështja në këndvështrim të parashikimeve ligjore respektive, trupi gjykues konkludoi se nuk ekzistonin kushtet për kalimin e gjykimit në formën e kërkuar prej subjektit.

12.1. *Së pari*, lidhur me aktet që subjekti ka paraqitur bashkëlidhur ankimit, rezulton se ato konsistojnë të gjitha në akte me natyrë procedurale të përpiluara e të paraqitura prej bashkëshortit, z. P. P., në kuadër të procedimit penal të zhvilluar ndaj tij, e që datojnë përkatësisht në vitet 2013-2015. Në këto rrethana, provohet që këto akte kanë ekzistuar në kohën e zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision, ndërsa subjekti nuk ka prezantuar asnjë fakt që të provojë se ato nuk janë paraqitur prej saj, pa faj në atë kohë, sipas kriterit për pranueshmërinë e tyre të parashikuar nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012. Përveç moskalimit të testit formal për pranimin e tyre, trupi gjykues i vlerësoi ato edhe në drejtim të vlerës së tyre provuese, lidhur me faktet që ato synonin të provonin, dhe konstatoi se ato lidheshin me çështje që i përkisnin procedimit penal në ngarkim të personit të lidhur, kundërshti e mosdakordësi të tij lidhur me akuzat e ngritura, çështje të cilat janë zgjidhur përfundimisht, tashmë me vendim përfundimtar, dhe nuk paraqesin asnjë relevancë për procesin e rivlerësimit, pasi i vetmi fakt i rëndësishëm lidhur këtë të fundit është deklarimi fajtor i personit të lidhur për veprat e akuzuara. Në këtë kuptim, aktet bashkëlidhur ankimit rezultuan të panevojshme për t' u marrë me cilësinë e provës edhe në kuptim të nenit 49, pika 6, gemat “a” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016. Ndërsa kërkesa e subjektit për të vënë në lëvizje Kolegjin për kërkimin e të gjithë dosjes penale të bashkëshortit të saj në Gjykatën e Lartë, përveç se e panevojshme për shkaqet e mësipërme, u vlerësua edhe në kundërshtim me detyrimin që mbartin subjektet në këtë proces lidhur me barrën e provës, në kuptim të nenit 4, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, si edhe nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

12.2. *Së dyti*, subjekti ka paraqitur, gjithashtu, një sërë aktesh bashkëlidhur aktit të titulluar “*shkaqe shitesë ankimi/parashtrim hyrës*”, të cilat ka kërkuar të merren me cilësinë e provës. Trupi gjykues, pasi konstatoi se këto akte janë paraqitur në një fazë procedurale në të cilën nuk lejohen të paraqiten akte të reja në kuptim të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, pasi janë dorëzuar në Kolegjin tri vite pas depozitimit të ankimit, dhe bëjnë të pamundur vlerësimin e arsyeve të mosparaqitjes së tyre në Komision, në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 84/2016, bëri një analizë të tyre vetëm në drejtim të nevojës për marrjen e tyre për zgjidhjen e çështjes, në zbatim të së drejtës së trupit gjykues për të marrë prova edhe kryesisht, sipas parashikimit të nenit 45 e 49 të ligjit nr. 84/2016. Nga kjo analizë, në mënyrë të përmbledhur, u konstatua dhe vlerësua si vijon.

12.3. Lidhur me dokumentin e paraqitur me parashtrime “Vërtetim i gjendjes gjyqësore”, gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik [Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve], më datë 16.10.2024, ku pasqyrohet se nga verifikimet që iu bënë shënimeve në regjistrin gjyqësor, rezulton se shtetasi P. P. është i padënuar, trupi gjykues vlerëson, *së pari*, se përfitimi nga instituti i rehabilitimit për dënimin penal të marrë me vendim gjyqësor përfundimtar, sipas parashikimeve të Kodit Penal, është një rrethanë që nuk afekton cilësimin e personit të lidhur si i dënuar për efekt të parashikimit të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016 dhe, *së dyti*, kualifikimi i personit të lidhur si “*person i përfshirë në krimin e organizuar*”, për shkak të procedimit e dënimit, për një vepër penale të parashikuar nga ligji nr. 10192/2009, është realizuar që në momentin e plotësimit të deklaratës për kontrollin e figurës, dhe do ta kishte humbur këtë cilësi më pas vetëm në eventualitetin e një vendimi pafajësie për këto vepra. Për rrjedhojë, në kuptim të parashikimeve të nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson të panevojshëm marrjen e këtij dokumenti si provë.

12.4. Lidhur me kontratën e shitblerjes nr. {***}, datë 11.12.2000, me palë shitëse Xh. Th. dhe F. Th. [bashkëshorti i hallës dhe vëllai i tij], të një sipërfaqe toke bujqësore për vlerën 1.800.000 lekë, rezulton se subjekti i rivlerësimit synon të provojë që në burimet e krijimit të shumës së dhënë hua prej huadhënësve Xh. e L. Th., duhet të përfshihet edhe e ardhura që vjen nga kjo kontratë, e cila do të përmirësonte në këtë rast analizën financiare të huadhënësve dhe, për pasojë, edhe të vetë subjektit.

12.5. Trupi gjykues e vlerësoi këtë akt vetëm në drejtim të peshës apo vlerës provuese që ai do të kishte në zgjidhjen e çështjes, duke abstraguar elementet që subjekti paraqet e që lidhen me mosdijeninë e saj për ekzistencën e këtij dokumenti, të cilat nuk paraqesin relevancë për sa kohë që akti nuk është paraqitur, jo vetëm gjatë hetimit administrativ, por edhe as me ankimin pas dhënies së vendimit, si në rast përjashtimor, i cili do të duhej të vlerësohej sipas parashikimit të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012. Përveç kësaj, trupi gjykues çmon të nënvizojë detyrimin e subjekteve për të paraqitur provat mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre, në zbatim të barrës së provës e cila sipas parashikimit të nenit 4, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës i takon subjektit të rivlerësimit.

12.6. Në lidhje me vlerën provuese dhe nevojën e trupit gjykues për marrjen kryesisht të këtij dokumenti me cilësinë e provës së re, konstatohet si vijon. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ajola Prençi, gjatë hetimit administrativ, në parashtrimet për rezultatet e tij, lidhur me një hua që ka shërbyer, sipas saj, për krijimin e pasurisë “Apartament” të ndodhur në qytetin e Shkodrës, e cila është deklaruar për herë të parë në pyetësin standard, ka deklaruar se është krijuar me të ardhurat e huadhënësve, halla e saj dhe bashkëshorti, nga shitja e tokave bujqësore të fituara nga ligji nr. 7501, duke specifikuar: **(i)** shumën prej 500.000 lekësh, sipas kontratë së shitblerjes nr. {***}, datë 23.07.1999, ku huadhënësi Xh. Th. [bashkëshorti i hallës] dhe familjarë të tij kanë shitur pasurinë në bashkëpronësi me nr. {***} dhe sipërfaqe 1500 m², në {***}, Shkodër; **(ii)** shumën prej 1.751.400 lekësh, të përfituar në datën 27.12.2001, sipas “kartelës së pasurisë së paluajtshme”, ku pasuria me nr. {***} dhe sipërfaqe 1668 m², në {***}, Shkodër, ka ndërruar pronësinë nga Xh.

Th. te shtetasi A. B. P.. Subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar përgjatë hetimit administrativ, por as në ankim se huadhënësit kanë siguruar të ardhura edhe nga kontrata e shitblerjes e paraqitur rishtas me parashtrime, të cilat janë përdorur për krijimin e shumës prej 1.500.000 lekësh, dhënë hua asaj dhe personit të lidhur në vitin 2004. Me pyetësin nr. 2, subjekti deklaroi se [...] justifikimi i burimeve ligjore të krijimit të shumës monetare që na është dhënë hua nga halla ime dhe bashkëshorti i saj do të bëhet me disa akte shkresore të mbledhura paraprakisht nga ana e tyre (me kërkesën tonë) një pjesë e këtyre pasurive është tjetërsuar nga ana e tyre, duke krijuar të ardhura monetare cash, ku nga dokumentacioni që më është dhënë kam mundur të evidentoj disa shitblerje, nga të cilat halla dhe bashkëshorti i saj kanë marrë të ardhura monetare. [...] dhe [...], bashkëlidhur dërgojmë dokumentacionin e AShK-së Shkodër, që më është dhënë nga halla dhe bashkëshorti i saj për të gjitha pronat e tyre (pronësi dhe bashkëpronësi) dhe ndryshimet e gjendjes juridike të tyre në vite, si dhe certifikatën e trungut familjar të bashkëshortit të hallës Xh. (Xh.) Th. për të evidentuar lidhjet e gjinisë me bashkëpronarët e tjerë. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur Aktin e Marrjes në Pronësi në emër të Xh. C. Th. dhe dokumentacionin e ZVRPP-së Shkodër për tokat bujqësore në pronësi/bashkëpronësi, si dhe për tjetërsimin e pronësisë për disa prej tyre.

12.7. Krahës deklarimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ, rezulton se Komisioni ka administruar edhe një deklaratë noteriale të huadhënësve të datës 27.12.2019, në të cilën ata deklarojnë se kanë dhënë hua shumën e pretenduar prej subjektit, e cila është krijuar ndër vite nga ana jonë (L. dhe Xh.), si rezultat i aktivitetit tregtar të shitblerjes së fruta-perimeve me shumicë e pakicë, që nga vitet 1992 e në vijim, ku 1.000.000 lekë të reja janë tërhequr nga llogaria jonë bankare pranë Bankës Kombëtare Tregtare, dega Shkodër dhe 500.000 lekë të reja nga gjendja që kishim në shtëpi. Nga ky dokument, për më tepër i krijuar në një kohë kur procesi i rivlerësimit kishte nisur dhe subjektet ishin ndërgjegjësuar për kërkesat dhe standardet e provueshmërisë që ishin vendosur nga organet e rivlerësimit, rezulton se vetë huadhënësit, nën peshën e këtij konteksti dhe të ndërgjegjësuar për përdorimin e kësaj deklarate, kanë identifikuar si burim të krijimit të shumës së dhënë hua të ardhurat e tyre nga biznesi, duke përjashtuar të ardhurat e krijuara prej shitblerjes së tokave të përfituara në zbatim të ligjit nr. 7501/1991. Në këto kushte, duket krejtësisht e pabesueshme që subjekti i rivlerësimit të përcaktojë një gamë më të gjerë burimesh për krijimin e shumës së dhënë hua, sesa ajo që përcaktojnë vetë huadhënësit, të cilët nga këto deklarime duket se shumën e përfituara prej shitjeve të tokave bujqësore duhet t'i kenë investuar apo shpenzuar për qëllime të tjera, dhe jo për të krijuar kursimet e huazuara subjektit dhe bashkëshortit në vitin 2004.

12.8. Kjo situatë shihet, gjithashtu, e lidhur edhe me faktin se Komisioni ka konkluduar për mosnjohjen e kësaj huaje si burim për krijimin e pasurisë mbështetur fillimisht në deklarin e pamjaftueshëm të subjektit, pasi ajo nuk e ka deklaruar këtë hua si burim në deklaratën vetting dhe as në atë periodike, rrethanë që e ka bërë të pabesueshme vetë ekzistencën e marrëdhënies dhe më pas, në një version garantist, ka analizuar edhe mundësinë e huadhënësve të pretenduar, për të krijuar shumën e deklaruar si të dhënë hua. Në këtë kuptim, siç do të arsyetohet edhe në vijim në analizë të shkaqeve që lidhen me vlerësimin të pasurisë, trupi gjykues e sheh pa relevancë përfitimin e shumës që vjen nga kontrata e shitjes e vitit 2000 prej huadhënësve, duke qenë se ata

vetë e kanë përjashtuar këtë të ardhur nga burimet e krijimit të shumës së dhënë hua, nëpërmjet përcaktimit të një burimi tjetër krijimi.

12.9. Për sa i përket pretendimeve të subjektit se Komisioni nuk ka kryer hetimet e duhura për zbulimin e transaksioneve të shitjes së familjes Th., trupi gjykues i gjen ato pa relevancë, duke qenë se Komisioni ka kryer hetime për verifikimin e deklarimeve të subjektit në deklaratën *vetting* dhe periodike, dhe ato të dhëna gjatë hetimit prej huadhënësve, deklarime të cilat as e kanë përmendur këtë veprim juridik si burim të krijimit të pasurisë. Siç arsyetohet në vendimin e Komisionit, fokusi i tij ka qenë analiza e shpjegimeve të subjektit kryesisht mbi ekzistencën e marrëdhënies së huas dhe më pas me një fokus më dytësor rreth ligjshmërisë së burimeve të huadhënësve. Në këtë kontekst, vlerësohen, po ashtu, të panevojshme edhe shkresat e paraqitura prej subjektit, me të cilat kërkon të provojë mungesën e hetimit prej Komisioni të çdo të ardhure që kanë krijuar ndër vite familja Th..

12.10. Përveç sa më sipër, trupi gjykues i gjen edhe të pabesueshme shpjegimet e subjektit rreth padijenisë së ekzistencës së kësaj kontrate shitblerjeje, duke qenë se nga aktet që ajo vetë prezanton duket se familjarë të afërt të saj, vëllai G. Y., por edhe vëllai tjetër i saj A. Y. (subjekt rivlerësimi), gjithashtu, kanë qenë në dijeni të plotë të kësaj kontrate dhe moszbulimi i kësaj rrethane te subjekti, e cila ndodhej paralelisht në fazën e hetimit administrativ si vëllai i saj, duket e pamundur të ketë ndodhur. Ky konkluzion i shërben trupit gjykues në funksion të vlerësimit të besueshmërisë së subjektit të rivlerësimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe veçanërisht ekzistencës së marrëdhënies së huas, e cila do të analizohet në vijim të këtij arsyetimi.

12.11. Për të gjitha sa u arsyetua më lart, trupi gjykues vlerësoi se aktet e paraqitura me cilësinë e e provës së re, kontrata e shitblerjes nr. {***}, datë 11.12.2000, shkresa me nr. {***} prot., datë 17.05.2023, e ASHK-së, Drejtoria Vendore Shkodër *[kthim përgjigje kërkesës së subjektit, nëse nga Komisioni është kërkuar informacion për pasuri të paluajtshme dhe veprime të tjetërsimit të tyre për shtetasit Xh. e L. Th., nëse po vënia në dispozicion e një kopje të këtyre akteve]*, si edhe korrespondenca e subjektit me Komisionin për informacion lidhur me dokumentacion të administruar prej ASHK-së për shtetasit Xh. e L. Th.⁸, të konsiderohen si të panevojshme për zgjidhjen e çështjes, në kuptim të nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

12.12. Lidhur me korrespondencën mes subjektit dhe institucioneve tatimore, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër⁹, rezulton se duke referuar si

⁸ Subjekti në datën 17.04.2023, i është drejtuar Komisionit me kërkesën me objekt “Kërkoj informacion”, e cila është administruar me nr. {***} prot., datë 19.04.2023. Në këtë kërkesë, subjekti shprehet se pas shpalljes së vendimit në ngarkim të saj, ka marrë CD me kopje të akteve, nga të cilave nuk ka konstatuar informacion të ASHK-së, lidhur me pasuritë e paluajtshme/tjetërsimin e tyre për shtetasit Xh. dhe L. Th., si dhe ka kërkuar informacion nëse nga Komisioni është kërkuar/administruar ky informacion. Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 28.04.2023, e ka informuar subjektin se pas pranimit të ankimit të saj ndaj vendimit nr. 470, datë 01.11.2021, dosja fizike e procesit të rivlerësimit kalimtar të saj është përcjellë pranë Kolegjit.

⁹ Subjekti i është drejtuar Drejtorisë e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën e administruar me nr. {***} prot., datë 19.04.2023 dhe ky institucion i ka kthyer përgjigje me shkresën nr. {***} prot., datë 10.05.2023.

bazë ligjore ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nenin 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe duke shpjeguar detyrimet që i burojnë nga procesi i rivlerësimit lidhur me marrëdhënien e huas me shtetasin Xh. Th., subjekti përmes këtyre shkresave ka adresuar disa pyetje lidhur me disponimin/administrimin e dokumentacionit me të dhëna për subjektet tatimore që kanë ushtruar veprimtari në periudhën 1990-2004, si dhe për subjektin tatimor “Xh. Th.”, me kod fiskal {***} dhe nr. serial {***}. Përgjigjet e të dy institucioneve nënvizojnë se të dhënat e kërkuara konsiderohen të dhëna konfidenciale, referuar kuadrit ligjor të zbatueshëm, duke orientuar paraqitje të kërkesës me shkrim prej Xh. Th. ose prokurën e posaçme prej tij. Përgjigjet e organeve tatimore të përcjella me shkresat që kërkojnë të administrohen si prova të reja, në vlerësimin e trupit gjykues, konfirmojnë një rregullim ligjor, i cili përveçse prezumohet i njohur për subjektin e rivlerësimit nuk jep asnjë informacion të vlefshëm për ndonjë prej çështjeve të analizuara prej Komisionit. Në këtë kuptim, ajo që subjekti i rivlerësimit synon të provojë me këto akte konsiderohet një prezumim ligjor i panevojshëm për t’u provuar, për pasojë vetë këto akte janë të panevojshme për zgjidhjen e çështjes, në kuptim të nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

12.13. Lidhur me publikimet e listuara në poshtëshënimin 6, nënpikat “v” dhe “vi”, të paraqitura prej subjektit me parashtrime, në mbështetje të pretendimeve, lidhur me llogaritjen e shpenzimeve të jetesës së huadhënësve/familjes Th., por edhe të familjes së saj, vlerësohen si të panevojshme, në kuptim të parashikimeve të nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, në konsideratë të praktikës së konsoliduar të organeve të rivlerësimit se niveli i shpenzimeve të jetesës sipas INSTAT-it, është vlera dysHEME nën të cilën mund të pretendohet vetëm bazuar në prova që dokumentojnë përjashtimin nga ky standard ligjor i aplikuar tashmë në të gjitha proceset e rivlerësimit të kryera prej organeve të rivlerësimit.

12.14. Lidhur me kërkesën e subjektit për thirrjen si dëshmitarë të huadhënësve Xh. dhe L. Th., trupi gjykues e vlerëson të panevojshme, në kuptim të nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, përderisa në fashikujt e Komisionit është e administruar deklarata e tyre noteriale në funksion të konfirmimit të marrëdhënies së huas me subjektin e rivlerësimit dhe marrëdhënia e huadhënës L. Th. me subjektin [halla] nuk sugjeron për deklarime të ndryshme nga ato të subjektit e që do të kishin vlera të posaçme provues për faktet e marra në analizë.

12.15. Lidhur me kërkesën e subjektit për administrim të Vërtetimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, datë 16.10.2024, me të cilin synon të provojë punësimin e bashkëshortit P. P. pranë subjektit “{***}”, me NIPT {***}, prej datës 18.02.2020, sipas saj, në përgjigje të kërkesës që ajo i ka bërë për të mos punuar në sistemin gjyqësor, për vendosjen e një ekuilibri në mes ruajtjes së familjes dhe moscenimit të perceptimit publik të punës dhe figurës së saj si prokurore, trupi gjykues konstaton se fakti i cili synohet të provohet konsiderohet pa relevancë, lidhur me analizimin e shkakut të ankimit që i përket kriterit të figurës. Gjithashtu, pa peshë konsiderohet edhe dokumentacioni që synon të provojë situatën që lidhet me pasojat pas përfundimit të

ekzekutimit të vendimit penal apo rehabilitimit të personit të lidhur, të cilat, siç u arsyetua edhe më sipër, nuk impaktojnë konkluzionet për kontrollin e kriterit të figurës, të cilat janë të lidhura me elementet që përcakton pika 15, e nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, të cilat nuk rezultojnë se kanë ndryshuar.

12.16. Kërkesa për administrimin e vendimit nr. {***} prot., datë 17.06.2022, të Komisionit, që i përket subjektit të rivlerësimit A. Y., përveçse përfaqëson një vendim i cili nuk ka marrë formë të prerë, por gjendet nën kontrollin rishikues të Kolegjit për shkak të ankimit të paraqitur, për pasojë nuk mund të përdoren konkluzionet e tij apo faktet e pranuar si të provuara në të, në çështjen objekt shqyrtimi, është gjithashtu edhe një akt i aksesueshëm në burime të hapura, element që e bën të panevojshëm administrimin e tij në mënyrë të posaçme.

12.17. Për sa më sipërshtetuar, trupi gjykues vendosi të refuzojë marrjen me cilësinë e provave të reja të akteve të paraqitura me parashtrimet e sjella nga subjekti, duke qenë se ato përveçse nuk plotësojnë kriteret formale për pranueshmërinë e tyre u vlerësuan të panevojshme për zgjidhjen e çështjes dhe pa ndikim në konstatimin e saktë dhe të plotë të situatës faktike.

13. *Lidhur me pretendimet për shkelje të rënda procedurale në kuadër të formës së gjykimit*, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të ngritura në ankim, por edhe në parashtrimet e sjella në Kolegj lidhur me shkeljet me natyrë procedurale, të cilat mund të afektonin formën e gjykimit në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, nëse do të konsideroheshin të rënda, siç subjekti ka parashtruar.

13.1. Lidhur me aktin e titulluar “Shkaqe shtesë ankimi/parashtrim hyrës”, nga shqyrtimi i përmbajtjes së tij, trupi gjykues e sheh me vend të bëjë një konsideratë të përgjithshme, sipas së cilës rezulton se subjekti ka ngritur në të pretendime të reja apo të ndryshme nga ankimi i saj, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me: **(i)** kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke synuar ndryshimin e situatës financiare të personave të lidhur/huadhënësve Th. për huan e pretenduar prej 1.500.000 lekësh dhe kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike; **(ii)** kriterin e figurës, në funksion të trajtimit/interpretimit të marrëdhënies së saj me shtetasin P. P. (bashkëshorti), si i rehabilituar për efekt të ligjit penal; **(iii)** si edhe për procesin e rregullt ligjor. Neni 47 i ligjit nr. 49/2012, në bazë të së cilit subjekti paraqet dhe kërkon të shqyrtohet materiali i sipërcituar dhe aktet bashkëlidhur tij, parashikon se: *Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohej prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj*, ndërsa neni 49 i po këtij ligji, i cili parashikon të drejtën e palëve për paraqitjen e parashtrimeve para seancës gjyqësore, mbi të cilën subjektet legjitimohen të sjellin një akt shtesë për t'u pasur në konsideratë prej trupit gjykues, parashikon se: *[...] Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim*. Të dyja këto dispozita, përcaktojnë rregullat procedurale se: **(i)** ankuesi në ankim si rregull nuk mund të paraqesë as fakte të reja dhe as prova të reja, që do të thotë se gjykimi në apel do të zhvillohet duke kontrolluar vendimin e

dhënë në gjykimin në shkallë të parë, në këtë rast në Komision, mbështetur në të njëjtat fakte dhe prova, përveç kur provohet rregulli përjashtues i mospasjes faj për mosparaqitjen e tyre në shkallë të parë, situatë e cila nuk provohet të ketë ndodhur në rastin objekt shqyrtimi, aq më tepër se konstatimi për shkaqe shtesë bëhet në parashtrime në raport me ankimin dhe jo me faktet e prezantuara në hetim; **(ii)** palët kanë të drejtë të paraqesin parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, që nënkupton se në parashtrime nuk mund të paraqiten shkaqe të reja, të cilat as janë ngritur në shkallën e parë dhe as në ankim. Në këtë kuptim, parashtrimet janë shpjegime shtesë të fokusuara në çështjet më të rëndësishme të ankimit e që i shërbejnë trupit gjykues për të përqendruar diligjencën në ato problematika që janë të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes. Në këtë kontekst, paraqitja e shkaqeve të reja në aktin e titulluar *shkaqe shtesë ankimi*, vlerësohen prej trupit gjykues se nuk mund t'i nënshtrohen juridiksionit kontrollues dhe rishikues të Kolegjit, për shkak të kufizimeve që parashikojnë dispozitat e mësipërme.

13.2. Gjithashtu, vendime të Kolegjit, të cilat datojnë pas paraqitjes së ankimit prej subjektit [cituar në poshtëshënimin 11], nuk mund të justifikohen se *përbëjnë rrethana të reja* për të motivuar shkaqe shtesë ankimi, për sa qëndrimet e mbajtura nga Kolegji në jurisprudencën e tij mbahen në konsideratë nga trupi gjykues, në zbatim të parimit të sigurisë juridike e trajtimit të barabartë të subjekteve, pa qenë nevoja të shtrohen si shkaqe shtesë, për të cilat duhet të ketë një arsyetim ligjor e analizë të situatës faktike të dedikuar. Për më tepër, numri i konsiderueshëm i vendimeve të Kolegjit referuar prej subjektit¹⁰, rezulton se dëshmojnë pikërisht koherencën e Kolegjit në gjykimin dhe vlerësimin e rrethanave faktike të secilit rast, pavarësisht ngjashmërisë në vështrim të parë të tyre, element që garanton trajtimin edhe të ankimit të subjektit në konsideratë të jurisprudencës së krijuar, kur ajo mund të jetë e zbatueshme. Për pasojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit të ngritura në këtë akt do të vlerësohen në harmoni e të integruara me shkaqet e ankimit dhe do të marrin përgjigje sipas kësaj logjike, duke abstraguat analizën mbi shkaqe të shfaqura rishtas, përtej kufijve të ankimit të paraqitur brenda afatit ligjor.

13.3. *Së pari*, trupi gjykues shqyrtoi kërkesën e paraqitur prej subjektit në “*Shkaqe shtesë ankimi-parashtrim hyrës*”, që bazuar në nenin 108 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Kolegji të konstatojë pavlefshmërinë absolute të vendimit objekt ankimi, për shkak të shkeljes së dispozitave urdhëruese të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me procedurën e marrjes së vendimit. Sipas subjektit, në kundërshtim me nenin 55, pika 5, e ligjit nr. 84/2016¹¹, që parashikon pjesëmarrje të detyrueshme të personave të evidentuar në këtë

¹⁰ Subjekti referon vendime të Kolegjit, ndër të tjerë, nr. 45/2023 (JR), nr. 47/2023 (JR), nr. 4/2024 (JR), nr. 9/2020 (JR), nr. 24/2021 (JR), nr. 25/2021 (JR), nr. 37/2021 (JR), nr. 20/2022 (JR), nr. 29/2022 (JR); nr. 2/2023 (JR), nr. 2/2023 (JR), nr. 6/2022 (JR), nr. 34/2022 (JR), nr. 2/2023 (JR), nr. 15/2019 (JR); nr. 11/2019 (JR); nr. 6/2022 (JR), nr. 12/2020 (JR); nr. 18/2021 (JR), nr. 17/2022 (JR); nr. 19/2023 (JR), nr. 12/2024 (JR); nr. 3/2024 (JR); nr. 28/2020 (JR); nr. 6/2022 (JR), nr. 34/2022 (JR), nr. 2/2023 (JR); si dhe vendimin e GjEDNJ-së për subjektin e rivlerësimit A. S..

¹¹ Neni 55 i ligjit nr. 84/2016, në pikën 5, përcakton: “[...] 5. Bisedimet për marrjen e vendimit ndaj subjektit të rivlerësimit zhvillohen me dyer të mbyllura në praninë e vëzhguesit ndërkombëtar. Vendimi i Komisionit merret me votim të hapur dhe me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të trupit gjykues. Nëse gjatë vendimmarrjes ka qëndrime të ndryshme nga ai i shumicës, komisioneri i mbetur në pakicë arsyeton me shkrim mendimin e tij. Vëzhguesi

dispozitë, mungesa e të cilëve në marrjen e vendimit e bën procedurën e pavlefshme, në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit të datës 29.10.2021, nuk evidentohet prania e vëzhguesit ndërkombëtar, fakt i tentuar të fshihet në vendim ku citohet se në marrjen e vendimit vëzhguesi ndërkombëtar ka qenë i pranishëm. Subjekti pretendoi se bazuar në parashikimet e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, vendimmarrja në shkelje të rënda procedurale, përbën shkak për shqyrtimin e këtij pretendimi në seancë gjyqësore publike, sikundër Kolegji ka mbajtur qëndrim për shkak të nevojës për riparimin e këtyre shkeljeve¹².

13.4. Nga aktet në fashikuj, konstatohet se bisedimet e trupit gjykues të Komisionit, për marrjen e vendimit objekt shqyrtimi për subjektin e rivlerësimit Ajola Prençi, janë dokumentuar në tri procesverbale, respektivisht të datës 25.10.2021, ku evidentohet prania e vëzhguesit ndërkombëtar dhe në dy procesverbale të datës 29.10.2021. Në procesverbalin e datës 25.10.2021, pasqyrohet fakti se trupi gjykues i Komisionit, edhe me dakordësinë e vëzhguesit ndërkombëtar Steven Kessler, ka vendosur shtyrjen e seancës për në datën 29.10.2021, me qëllim kryerjen e verifikimit në vend të regjistrat noterial të noteres publike L. H., me zyrë në qytetin e Shkodrës, lidhur me dyshimet e lindura mbi vërtetësinë e aktit-kontratë huadhënie me nr. {***} rep., datë 23.11.2004. Në procesverbalin e datës 29.10.2021, të mbajtur nëpërmjet shkrimit kompjuterik dhe të nënshkruar prej trupit gjykues, pasqyrohet fakti se pas diskutimit lidhur me verifikimin e kryer pranë noterit në datën 27.10.2012, konkluzionet e të cilit janë paraqitur në procesverbalin e mbajtur në vend dhe administruar në dosje, trupi gjykues i Komisionit ka vlerësuar se nuk kishte arsye ligjore për rihapje të hetimeve dhe se është vijuar me vendimmarrjen. Në procesverbalin tip, të mbajtur me shkrim dore, të titulluar *“Procesverbal i vendimmarrjes së trupës gjyqësore të KPK-së për procesin e rivlerësimit për Ajola Prençi”*, është pasqyruar prezenca e trupit gjykues dhe të njëjtit vëzhgues ndërkombëtar dhe nënshkrimi i tij krahas emrit, si edhe lloji i vendimit të marrë në këtë datë për çështjen e subjektit, si *shkarkim*.

13.5. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se procedura e ndjekur nga Komisioni për marrjen e vendimit ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Ajola Prençi, është në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 55, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Mospasqyrimi i pranisë së vëzhguesit ndërkombëtar në procesverbalin e mbledhjes, ku anëtarët e trupit gjykues të Komisionit kanë diskutuar për rihapje ose jo të hetimeve mbi bazën e rezultatit të verifikimeve të kryera pranë noterit, nuk barazohet me atë të marrjes së vendimit përfundimtar dhe konsideruar edhe rolin aktiv të vëzhguesit në çështje, në referim edhe të pyetjeve të drejtuara prej tij në seancën dëgjimore, vlerësohet si një *ometim* i pasqyrimin të prezencës së tij në marrjen e atij vendimi. Kjo analizë vjen edhe për shkak të faktit që në procesverbalin e mbajtur me shkrim dore, në të cilën pasqyrohet edhe lloji i disponimit të trupit gjykues, si një vijim i procesit që kishte nisur nëpërmjet analizës së rezultateve për këqyrjen e kryer në zyrën noteriale dhe të pasqyruar në procesverbalin e po kësaj

ndërkombëtar ka të drejtë të shkruajë një mendim ndryshe/paralel që i bashkohet vendimit. Procesverbali i bisedimeve të çështjes mbahet nga personeli i regjistrat të Komisionit. [...]”

¹² Subjekti referon qëndrimin e mbajtur nga Kolegji në vendimin nr. 43, datë 15.11.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit H. M..

date [në të cilën nuk figuron emri i vëzhguesit ndërkombëtar], pasqyrohet prezenca e tij dhe nënshkrimi që konfirmon marrjen e vendimit të shkarkimit në prezencë të tij. Për pasojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se diskutimet për marrjen e vendimit janë zhvilluar në mungesë të vëzhguesit ndërkombëtar të çështjes, në kundërshtim me parashikimet e nenit 55, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, nuk mbështeten në të dhënat që burojnë nga akte në fashikull dhe vlerësohen nga trupi gjykues si të pabazuara.

13.6. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrime, kërkoi që Kolegji të konstatojë se në cenim të parimit të *gjykatës së paanshme*, komisionerja B. B. ka qenë në konflikt interesi faktik gjatë zhvillimit të procesit të saj të rivlerësimit, pasi po hetohej penalisht për një problematikë të deklarimit të pasurisë, në thelb e ngjashme, madje më e rëndë se situata e saj e mosdeklarimit të huas. Sipas subjektit, në kohën e ushtrimit të ankimit nuk ka qenë në dijeni të këtij fakti, me pasojë prishjen e vendimit të Komisionit si të marrë haptazi në kundërshtim me parimet kushtetuese për procesin e rregullt ligjor të sanksionuara edhe nga aktet ndërkombëtare.

13.7. Duke pretenduar se për këtë rrethanë ka marrë dijeni rreth dy muaj pas ushtrimit të ankimit, përmes publikimit të vendimit të GjKKO-së, që nuk pranoi kërkesën e SPAK-ut për pushimin e hetimeve ndaj komisioneres, subjekti i rivlerësimit pretendon se, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave”, nenit 72, pika 6 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 27 të ligjit nr. 84/2016, komisionerja B. ishte e detyruar të jepte dorëheqjen, për shkak se ishte në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti thekson qëndrimin e mbajtur nga Komisioni në raste të ngjashme, duke përmendur si të tillë *vendimin e ndërmjetëm të Komisionit për pranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit A. Y. për përjashtimin e komisioneres E. Ç. [marrë e pandehur në atë kohë]*.

13.8. Lidhur me këtë pretendim, duke abstraguuar nga koha e paraqitjes së tij, por duke e marrë në analizë si një element që mund të cenonte parimin e *gjykatës së krijuar me ligj*, për shkak të qenies në kushtet e konfliktit të një anëtarit të Komisionit, si një rrethanë që mund të përfaqësojë një shkelje të rëndë procedurale me pasojë cenimin e procesit të rregullt ligjor, trupi gjykues konstaton dhe analizon si vijon. *Së pari*, nga burime të hapura konstatohet se përgjatë periudhës janar 2020-qershor 2022, në media janë bërë publike si kallëzimi ndaj komisioneres B. në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar [shtator 2020] dhe dinamikat vijuese deri në shpalljen e vendimit të GjKKO-së me nr. 84 akti, datë 29.06.2022, për pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme dhe pushimin e procedimit penal nr. 232/2020, për veprat penale “Falsifikim i dokumenteve” dhe “Refuzimi për deklaram, mosdeklaram, fshehje ose deklaram i rremë i pasurive të personave të zgjedhor dhe nëpunësve publikë”, parashikuar nga nenet 186 dhe 257/a/2 të Kodit Penal [qershor 2022]¹³. Këto fakte të identifikueshme edhe aktualisht e bëjnë të

¹³ Shih, ndër të tjerë: <https://abcnews.al/komisionerja-e-kpk-brunilda-bekteshi-kallezohet-ne-spak/> <https://gazeta-shqip.com/aktualiteti/anetarja-e-kpk-se-brunilda-bekteshi-kallzohet-ne-spak-712/> <https://boldnews.al/2020/09/28/tjeter-kallezim-ne-spak-per-anetaren-e-kpk-se-brunilda-bekteshi/> <https://www.oranews.tv/vendi/pushohen-hetimet-per-anetaran-e-kpk-se-brunilda-bekteshi-i1047756> <https://a2news.com/gjikko-pushon-hetimin-ndaj-brunilda-bekteshit>

pabesueshëm pretendimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Ajola Prençi, se ajo është informuar për rrethanat lidhur me komisioneren B. vetëm pas shpalljes së vendimit, ndryshe nga vëllai i saj/subjekti i rivlerësimit A. Y., i cili nga publikimet në media ka marrë shkas për të kërkuar përjashtimin e komisioneres Ç.. *Së dyti*, trupi gjykues sjell në vëmendje se paraqitja e një kallëzimi penal ndaj një anëtarit të organeve të rivlerësimit, jo vetëm nuk përbën *a priori* arsye për të insinuar detyrimin për të dhënë dorëheqje, por, sipas këtij pretendimi, do të nxitej në mënyrë abuzive një fenomen negativ për vijueshmërinë e mirëfunksionimit të organeve të rivlerësimit, me pasojë në ecurinë e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. *Së treti*, vendimi i GjKKO-së, sipërcituar për pushimin e procedimit penal ndaj komisioneres, me të cilin subjekti prezumohet se është njohur, dëshmon mungesën e përgjegjësisë së komisioneres për akuzat që zhvillohej hetimi, duke e bërë të pabazuar pretendimin e subjektit se prania e komisioneres Bekteshi në trupën që ka kryer procesin e rivlerësimit të saj ka cenuar parimin e *gjykatës së paanshme*. *Së katërti*, edhe duke marrë të mirëqenë pretendimin për kohën kur ka marrë dijeni për rrethanat lidhur me komisioneren B., subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë që të vërtetojë paanshmërinë personale (subjektive) të komisioneres. Argumenti i vetëm - *komisionerja B. ishte e vetmja që e ka pyetur në seancën dëgjimore për rrethanat e mosdeklarimit të huas marrë shtetasve Xh. dhe L. Th.* – nuk dëshmon për ekzistencë të ndonjë elementi lidhur me paragjykimin e komisioneres, por për ushtrim të kompetencave të njohura nga ligji. Situata e pasjes në ngarkim të një procedimi penal gjatë kohës që ushtrohen funksionet shtetërore nuk prodhon automatikisht situatën e konfliktit të interesit, përderisa ligji nuk ka paraparë pezullimin nga detyra të funksionarit, por si në çdo rast tjetër konflikti i interesit do të duhej të vlerësohej në analizë të të gjitha rrethanave që përfaqësojnë testin objektiv dhe subjektiv, sipas jurisprudencës së krijuar për gjykatën e paanshme. Asnjë rrethanë e tillë nuk është prezantuar prej subjektit të rivlerësimit, për pasojë trupi gjykues e gjen këtë pretendim të pambështetur dhe qenien e Komisioneres B. në trupën gjykuese të Komisionit në përputhje me ligjin. Për rrjedhojë, në të gjithë këndvështrimet, pretendimet e subjektit, lidhur me *gjykatën e paanshme* e që Kolegji të konstatojë këtë fakt me pasojë prishjen e vendimit të Komisionit dhe rregullimin e pasojave bazuar në nenin 110 të Kodit të Procedurave Administrative, vlerësohen prej trupit gjykues vetëm si një përpjekje e pabazuar për të delegitimuar procesin e saj të rivlerësimit.

13.9. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues nuk evidentoi asnjë shkelje të rëndë procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike, në kuptim të situatave që përcakton neni 51 i ligjit nr. 49/2012, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike në Kolegj, me praninë e subjektit të rivlerësimit, për korrigjimin e tyre. Për rrjedhojë, trupit gjykues, në kushtet kur marrja e provave të reja u vlerësua si në shkelje të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, si edhe u konsideruan të panevojshme në kuadër të nenit 49, pika 6, gjerat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, ndërsa nuk rezultoi se ekziston asnjë prej situatave të parashikuara nga neni 51 i ligjit nr. 49/2012, vendosi të vijojë me shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimit të nenit 49, paragrafi 1 të ligjit nr. 49/2012.

B. Shqyrtimi i shkaqeve të ankimit

Shqyrtimi i shkaqeve procedurale të ankimit

14. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar për shkelje haptazi të një sërë parimesh të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, të cilat në thelb synojnë të kundërshtojnë konkluzionet dhe vendimmarrjen e Komisionit, dhe jo aspekte procedurale të procesit. Subjekti, pasi ka renditur parimet e procesit ligjor të shkelura prej Komisionit, sipas saj, me një parashtrim të shkurtër të argumenteve në nivel parimor, shprehet se *trajtimi i këtyre parimeve do të bëhet në secilin prej konstatimeve të Komisionit*. Pavarësisht se subjekti i parashtron në mënyrë të integruar shkaqet e ankimit me natyrë procedurale me ato të themelit, për lehtësi leximi të këtij vendimi, dhe sipas jurisprudencës së Kolegjit, trupi gjykues i analizoi shkaqet e ankimit të veçuara, sipas natyrës së tyre, në funksion të vlerësimit me qartësi më pas të pretendimeve të subjektit lidhur me situatën faktike të pretenduar. Në vijim, analiza e trupit gjykues.

14.1. Lidhur me pretendimin për pamundësi objektive për të realizuar një mbrojtje efektive, subjekti parashtron si shkak paraqitjen në raportin e rezultateve të hetimit administrativ dhe në vendim të fakteve dhe rrethanave që nuk lidhen me të, por me persona në lidhje martesore apo të afërt gjinie me të. Sipas saj, me aktin “Rezultatet e hetimit administrativ”, dërguar në datën 05.10.2021, Komisioni ka pasqyruar raporte të DSIK-së në lidhje me vëllain e saj, duke kërkuar dhënien e shpjegimeve [paraprakisht duke e ngarkuar me barrë prove] dhe, më pas, në seancë dëgjimore nuk është lejuar të japë shpjegime, duke iu bërë e ditur prej kryesueses *se nuk kishte barrë prove* dhe duke mos e lejuar të flasë. Rrethanat lidhur me vëllanë e saj, për të cilat nuk i është dhënë mundësia e mbrojtjes në seancë, janë pasqyruar në mënyrë të hollësishme në vendim, në mënyrë të panevojshme, të paligjshme dhe paragjyquese ndaj saj, kanë realizuar qëllimin e synuar për “*helmimin*” e figurës së vëllait të saj, e mbi këtë bazë edhe të figurës së saj nëpërmjet perceptimit publik.

14.2. Nga shqyrtimi i akteve në fashikujt e Komisionit, trupi gjykues konstaton si vijon.

Në raportin e Komisionit, për rezultatet e hetimit administrativ, në rubrikën “II. Kontrolli i figurës”, në pjesën “c. Gjetje të tjera”, pasqyrohet se: “[...] Nga verifikimi i kësaj deklarate [deklarata për kontrollin e figurës së vëllait të subjektit], rezultoi se në germën “ç”, të pjesës 5 “Të Dhëna për Sigurinë”, A. Y. në përgjigje të pyetjes “A keni pasur kontakte të përshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar në ushtrimin e detyrës tuaj?”, është përgjigjur me “PO” [...] subjekti i rivlerësimit Ajola Prençi në përgjigje të pyetjes “Nëse është në dijeni që një nga anëtarët e familjes suaj ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar”, është përgjigjur me “JO” [...] se vëllai im Gjyqtar A. Y. është pyetur si person që tregon rrethana hetimi nga Prokuroria për Krimet e Rënda dhe ka pasur kontakte me persona të përfshirë në proces. Nga vëllai im më është bërë i ditur fakti se kontaktet kanë qenë të përshtatshme dhe për shkak të detyrës. Nuk jam në dijeni për objektin e hetimit, personat e hetuar apo ecurinë e procesit. Kam marrë dijeni për faktin nga vëllai im në dhjetor 2014”. Sa më sipër, bazuar në

nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kërkuar shpjegime prej subjektit, duke iu referuar të gjithë konstatimeve në raport me të dhënat e plotësuar në deklaratën përkatëse dhe raportin e DSIK-së në tërësi¹⁴.

14.3. Në procesverbalin e seancës dëgjimore, lidhur me kontrollin e figurës, pasqyrohet se komisionerja relatore ka relatuar informacionet e rezultuara nga raporti i DSIK-së, dhe se Komisioni ka kryer një hetim të pavarur me qëllim provueshmërinë e informacionit, duke u shprehur, ndër të tjera [...] *gjithashtu, verifikoi edhe deklaratimet e subjektit lidhur me një kontakt të papërshtatshëm të vëllait të saj me iniciale A.Y. me të tretë. [...] Nga verifikimi dhe krahasimi i dy deklarimeve Komisioni ka vërejtur se subjekti ka deklaruar sipas deklarimeve të vëllait të saj. Duke ruajtur konfidencialitetin e çështjes, për sa kohë ai është subjekt rivlerësimi, në kushte kur çështja është ende në proces për vëllain e saj, është vlerësuar nga ana e Komisionit të mos bëhen publike detaje të rrethanave më tej. Lidhur me këtë kriter, Komisioni i kërkoj shpjegime subjektit duke iu referuar të gjithë konstatimeve [...].* Në vijim, në mënyrë të përmbledhur, është relatuar qëndrimi i subjektit [lidhur me faktin e dënimit penal të bashkëshortit], duke theksuar se në mënyrë të detajuar subjekti mund t'i shpjegojë në fjalën e saj. Subjekti në fjalën e saj, pasi ka parashtruar gjerësisht parashtrimet lidhur me çështjen e bashkëshortit, ka tentuar të vijojë me dhënien e shpjegimeve lidhur me çështjet që i adresoheshin vëllait të saj. Subjekti është ndërprerë në këtë ligjëratë nga kryesuesja e trupit gjykues të Komisionit, e cila i ka bërë me dije se është e panevojshme të vijojë me këtë shpjegim, sepse Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove për këtë çështje. Më pas, subjekti i është përgjigjur pyetjeve të Komisionit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

14.4. Lidhur me këtë situatë, në vendimin e Komisionit, pasqyrohet hetimi i thelluar i kryer lidhur me vërtetësinë dhe provueshmërinë e informacionit të pasqyruar në raportin e DSIK-së, ku, ndër të tjera, citohet se [...] *Komisioni nga informacionet konfidenciale që nuk mund t'i vihen në dispozicion subjektit, është bërë me dije se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kontaktin e papërshtatshëm të vëllait të saj A. Y. me të tretë. Në vijim të hetimit për këtë çështje rezultoi se shtetasi A. Y. është njëkohësisht subjekt rivlerësimi, për shkak të funksionit të tij si gjyqtar. Pa paragjykuar, por për të ezauruar edhe këtë konstatim të institucionit ligjzbatues, Komisioni, me vendim të ndërmjetëm nr. {***} prot., datë 23.07.2021, vendosi të administrojë deklaratën e plotësuar nga shtetasi A. Y., për llogari të kontrollit të tij për kriterin e figurës. [...].* Pas pasqyrimit të hetimit administrativ të kryer, qëndrimit dhe provave të paraqitura prej subjektit, ku lidhur me përfshirjen e të dhënave të vëllait ka ngritur pretendime për raportin e DSIK-së se [...] *e konstatoj tërësisht të qëllimtë përfshirjen e të dhënave të vëllait tim në vlerësimin e figurës sime, bërë me qëllimin e vetëm për të krijuar situata të disa familjarëve të mi, për të shkaktuar amulli dhe për të krijuar bindjen te ju se për shkak të tyre edhe unë jam e papërshtatshme në ushtrimin e detyrës [...],* Komisioni, në lidhje me mosdeklarimet e subjektit për kontaktin e papërshtatshëm të vëllait

¹⁴ Lidhur me vëllain e subjektit, nga raporti i DSIK-së, citohet se: [...] *Të dhënat e përcjella nga autoritetet verifikuese flasin vetëm për vëllain e znj. Prençi ku informojnë për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës (vëllai i subjektit) është, gjithashtu, subjekt rivlerësimi dhe do të shqyrtohet si i tillë.*

të saj A. Y. me të tretë, në vlerësim: **(i)** të shpjegimeve të dhëna prej saj në prapësime; **(ii)** të deklarimit të bërë nga i vëllai i saj në deklaratën noteriale të depozituar¹⁵, ka vlerësuar të panevojshme daljen në konkluzion për këtë çështje, për sa kohë vëllai i subjektit është njëkohësisht subjekt rivlerësimi dhe i nënshtrohet personalisht hetimit administrativ.

14.5. Nga sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se Komisioni nëpërmjet pasqyrimit të gjetjeve të DSIK-së, në rezultatet e hetimit por edhe në vendim, hetimit të kryer, duke administruar deklaratën për kontrollin e figurës së vëllait të saj, kërkesës për të dhënë shpjegime, bazuar në parashikimet e nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, zbulimit e komunikimit subjektit, në një nivel të mjaftueshëm e të arsyeshëm rrethana, fakte dhe identitete personash, për çështje e individë që mund të përbënin shkak për ta konsideruar subjektin si të papërshtatshëm sipas vlerësimit të Komisionit, ka vepruar në ushtrim të kompetencave të njohura nga ligji nr. 84/2016, për kryerjen e një kontrolli të plotë lidhur me kriterin e figurës. Fakti që Komisioni ka vlerësuar të panevojshme dhënien e shpjegimeve prej subjektit në drejtim të vëllait në seancë gjyqësore, nuk mund të pretendohet si cenim i të drejtës për t'u mbrojtur përderisa subjektit i është bërë më dije se për këtë çështje nuk i është kaluar barra e provës, dhe se me shpjegimet e saj në parashtrime i janë dhënë përgjigje çështjeve të ngritura në raportin për rezultatet paraprake të hetimit. Pasqyrimi në vendim i të dhënave të kanë rezultuar nga hetimi i kryer, lidhur me verifikimin dhe saktësinë e informacionit të pasqyruar në raportin e DSIK-së për vëllain e saj A. Y. dhe konkluzionit të arritur, vjen në zbatim të urdhërimeve të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, ku parashikohen elementet e formës dhe të përmbajtjes së vendimit të arsyetuar të Komisionit. Vendimi i marrë prej Komisionit është akti përfundimtar i një procesi të rëndësishëm hetimor, për pasojë të dhënat që kanë dalë nga hetimi e që janë përcjellë subjektit me kërkesën për dhënie shpjegimi, natyrshëm bëhen pjesë e pasqyrimit të fakteve në vendim, por edhe të procedurave të kryera prej Komisionit për verifikimin e tyre. Gjithashtu, pasqyrimi nuk rezulton të dëmtojë në mënyrë të posaçme as subjektin e rivlerësimit, për sa kohë ajo nuk ka marrë asnjë pasojë prej problematikave lidhur me vëllain e saj, por as për vetë vëllain e subjektit, për të cilin këto të dhëna kanë qenë në fokus të hetimit administrativ dhe rezulton se janë trajtuar gjerësisht në vendimin e marrë për procesin e tij të rivlerësimit¹⁶. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit se ky qëndrim i Komisionit është në cenim të hapur të procesit të rregullt ligjor, si në drejtim të saj ashtu edhe të vëllait të saj A.Y., vlerësohet nga trupi gjykues i pabazuar.

14.6. Lidhur me pretendimin për shkelje të parimit të objektivitetit, subjekti parashtroi se vendimmarrja, në lidhje me kriterin e pasurisë dhe figurës, nuk ka marrë në konsideratë asnjë rrethanë objektive dhe nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve të saj ku pasqyroheshin qartësisht këto rrethana, duke e bërë vendimin e Komisionit tërësisht të paarsyetuar. Sipas saj, cenimi i këtij parimi shfaqet në faktin e mospërfshirjes në analizën financiare: **(i)** të kursimeve nga paga të bashkëshortit për vitin 2003; **(ii)** të huas të marrë nga halla në vlerën 1.500.00 lekë; **(iii)** të të

¹⁵ Nr. {***} rep., datë 13.10.2021.

¹⁶ <https://kpk.al/wp-content/uploads/2023/02/Vendim-A.-Y..pdf>

ardhurave të bashkëshortit nga bonusi i transportit dhe dietat për vitet 2011 dhe 2012; si dhe (iv) të vlerësimit të gabuar të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2016, të cilat në një analizë të drejtë dhe objektive tejkalojnë bindshëm vlerën e balancës negative të rezultuar. Gjithashtu, me pretendimin se *ndëshkohet për shkak* të bashkëshortit, në lidhje me një situatë që ka ndodhur 8 vite më parë, subjekti pretendon se në kontekst të vlerësimit të Komisionit për marrëdhënien me bashkëshortin, i cili ishte i qartë që në momentin e paraqitjes së raportit të rezultateve të hetimit administrativ kryesisht, Komisioni nuk i ka dhënë përgjigje asnjë prej trajtimeve të saj juridike në parashtrimet e paraqitura, për pasojë vendimmarrja ndaj saj nuk ka qenë rrjedhojë e një veprimtarie të paanshme nga Komisioni, ndërsa vendimi është i paarsyetuar në shkelje të hapur të procesit të rregullt ligjor.

14.7. Përkundër sa pretendon subjekti i rivlerësimit, vendimi i Komisionit, sipas përcaktimit të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, përmban çdo element të formës, pjesën hyrëse, përshkruese-arsyetuese dhe urdhëruese. Në përmbajtje të secilës pjesë përbërëse, janë renditur rregullisht, me lidhje organike, elementet përkatëse, pasqyrohen shpjegimet dhe provat e paraqitura prej subjektit, analiza dhe interpretimi i tyre në raport me rrethanat faktike që kanë rezultuar nga hetimi, si edhe shoqërohet e gjithë përmbajtja e vendimit nga një arsyetim logjik i bazuar në fakte që kanë rezultuar prej provave të administruara në fashikuj. Fakti që lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë Komisioni ka konkluduar se për shkak të shpjegimeve jo konsistente të subjektit, lidhur me pasurinë “Apartament”, në Shkodër dhe provave të paraqitura, subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë të kundërtën e barrës së provës, nuk dëshmon se Komisioni nuk ka konsideruar kontributin e subjektit në hetim. Konkluzionet e Komisionit rezultojnë të jenë produkt i analizës së tij mbi ligjin e faktet e rezultuara prej hetimit, si një proces logjik i kryer brenda tagrave diskrecionale të Komisionit, në përputhje me përcaktimet e neneve 45 e 49 të ligjit nr. 84/2016.

14.8. Lidhur me pretendimin se nuk i është dhënë përgjigje trajtimeve të saj juridike në parashtrime sa i përket vlerësimit të marrëdhënies me bashkëshortin, trupi gjykues konstaton se në vendimin objekt shqyrtimi, ndër pretendimet shtesë të paraqitura prej subjektit lidhur me çështjen e dënimit penal të bashkëshortit, pasqyrohet edhe sa parashtruar prej saj lidhur me mbrojtjen që gëzon marrëdhënia martesore dhe interesi i fëmijëve në nivel kushtetues dhe nga aktet ndërkombëtare. Lidhur me këtë pretendim, rezulton se Komisioni ka arritur në konkluzionet e tij për sa i përket marrëdhënies së subjektit me bashkëshortin e saj, në kuptim të parashikimeve të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, si pasojë e dënimit me vendim gjyqësor të formës së prerë, për një vepër që përfshihet në ligjin nr. 10192/2009, duke e mbështetur analizën e tij për këtë konkluzion në parimet dhe kushtet e parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, të materializuara në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016. Mosreferimi te kuadri ligjor i propozuar/sugjeruar prej subjektit nuk vlerësohet se *apriori* krijon premisa për cenim të procesit të rregullt ligjor, për sa kohë që orientimi i Komisionit drejt zbatimit të legjislacionit të posaçëm që rregullon situatën e konstatuar për subjektin dhe bashkëshortin është i drejtë dhe në zbatim të parimeve universale të së drejtës se *lex specialis derogat legi generali*. Identifikimi i ligjit të zbatueshëm është një tagër i organit që trajton dhe zgjidh çështjen, i cili ka për detyrë të përcaktojë atë qartësisht dhe jo detyrimisht të japë

përgjigje apo shpjegime përse sugjerimi i një legjislacioni tjetër nuk është i duhuri. Trupi gjykues vlerëson se Komisioni, duke identifikuar ligjin e zbatueshëm sipas vlerësimit të tij, ka garantuar procesin e rregullt ligjor, edhe në mungesë të një arsytimi refuzues, i cili është i nënkuptuar gjithsesi, për zbatimin e legjislacionit të propozuar prej subjektit. Në këtë këndvështrim, analizimi i pretendimeve mbi bazën e ligjit të zbatueshëm nuk e bën vendimin të paarsyetuar, sikundër nuk cenon as procesin e rregullt ligjor, edhe në dritën e qëndrimeve të Gjykatës Kushtetuese¹⁷, si edhe të GjEDNj-së se *neni 6/1 i KEDNj-së i detyron gjykatat të japin vendime të arsyetuara, por kjo nuk duhet të kuptohet si detyrim për të dhënë përgjigje të detajuara për çdo argument*¹⁸. Për rrjedhojë të sa më lart analizuar, pretendimet e subjektit vlerësohen të pabazuara.

14.9. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin për shkelje të parimit të ligjshmërisë e proporcionalitetit, sipas së cilit subjekti parashtroi se është ndëshkuar me masën më ekstreme për gabime dhe pakujdesi në deklarimin e pasurisë, të cilat nuk mund të japin pasojë, si edhe duke vlerësuar figurën e saj mbi shkaqe e rrethana që nuk lidhen me të, pa marrë në konsideratë arritjet e saj profesionale, rrethanat lehtësuese, se është diskriminuar haptazi për shkak të lidhjes së saj martesore, dhe se në vlerësimin e figurës është ndëshkuar për një fakt të gjykuar dhe vuajtur më parë, si prej bashkëshortit dhe prej saj, në shkelje të parimit të gjësë së gjykuar dhe gjykimit dy herë për të njëjtin fakt. Në vijim, analiza dhe konkluzioni i trupit gjykues.

14.10. Nga analizimi i këtyre pretendimeve, *së pari*, konstatohet se ato i adresohen vlerësimit të Komisionit për deklarim të pamjaftueshëm të subjektit lidhur me pasurinë “Apartament”, të ndodhur në Shkodër, për shkak të mosdeklarimit në deklaratën *vetting* dhe deklaratat e pasurisë ndër vite si burim të krijimit të saj, të huas në shumën 1.500.000 lekë. Duke pretenduar se mosdeklarimi i huas ka ardhur si pasojë e gabimit njerëzor, subjekti parashtroi se në raste të subjekteve të tjerë, Komisioni ka mbajtur qëndrim të ndryshëm duke i quajtur bindëse shpjegimet e tyre dhe se vetë Kolegji në praktikën e tij nuk e ka konsideruar penalizues mosdeklarimin në deklaratën *vetting* të huave, të cilat nuk kanë ekzistuar në momentin e plotësimit të saj.

14.11. Në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit në jurisprudencën e tij, lidhur me pretendime për standarde të ndryshme të Komisionit për çështje të ngjashme, trupi gjykues risjell në vëmendje: *së pari*, konkluzioni rreth dy standardizimeve lidhet domosdoshmërisht me analizat specifike të çdo rasti, të cilat meritojnë trajtim individual e, për pasojë, krijojnë vështirësi apo edhe pamundësi për marrjen e një qëndrimi përgjithësues për raste me tipare të ngjashme, për konstatimin e standardit të pretenduar si të dyfishtë; *së dyti*, përgjegjësinë e Kolegjit si i vetmi organ gjyqësor i procesit të rivlerësimit, i cili garanton ruajtjen e trajtimit të barabartë të subjekteve, qoftë për shkak të ushtrimit të funksioneve gjyqësore, por edhe për shkak të kompozimit të tij. Në këtë kontekst, konstatohet se vendimet e Komisionit, për të cilat subjekti pretendon një qëndrim me standard të ndryshëm nga i saj, janë referuar prej saj në Komision, për rrjedhojë, në nivel teorik prezumohet se pretendimi për trajtim të ndryshëm është rrjedhojë e situatave në dukje të ngjashme. Në

¹⁷ Shih vendimet nr. 12, datë 19.3.2015 dhe nr. 26, datë 27.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁸ Vendimi i GjEDNj-së në çështjen Garcia Ruiz kundër Spanjës.

kontekstin e pretendimeve për standarde të dyfishta, subjekti ka sjellë në vëmendje se në një rast të ngjashëm me të saj, Kolegji nuk ka konsideruar penalizues mosdeklarimin në deklaratën *vetting* të huave që nuk kanë ekzistuar në momentin e plotësimit të deklaratës, duke referuar vendimin nr. 9 (JR), datë 26.06.2020, të Kolegjit, si jurisprudencën që konfirmon pretendimin e saj. Për të konkretizuar analizën teorike të bërë më sipër rreth standardeve të dyfishta, trupi gjykues konstaton se rasti i trajtuar me vendimin e referuar nga subjekti i përket një shtate faktike të ndryshme dhe nuk mund të ketë analogji në trajtimin e tyre. Në vendimin e referuar prej subjektit, rezulton se objekt analize ka qenë një marrëdhënie huaje e vitit 2009 [huadhënës subjekti i rivlerësimit] e shlyer në kohë dhe e padeklaruar në deklaratën *vetting*, duke qenë se nuk ekzistonte më si detyrim në kohën e përpilimit të saj. Kjo hua në çështjen e referuar, për më tepër e dhënë nga subjekti të një shtetas tjetër, nuk kishte shërbyer në asnjë rrethanë si burim për krijimin e ndonjë pasurie, edhe pas kthimit të saj, por ishte marrë në analizë vetëm për efekt të verifikimit të mundësisë së subjektit për të krijuar me burime të ligjshme shumën e dhënë hua. Në rastin objekt shqyrtimi, Komision ka konkluduar se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me mosdeklarimin e huas në deklaratën *vetting*, por as në deklaratat periodike, për shkak të faktit se shumta e pretenduar si e marrë hua ka shërbyer për krijimin e pasurisë “Apartament”, në Shkodër dhe, për pasojë, subjekti Ajola Prençi ka pasur detyrimin ta deklarojë atë në deklaratën *vetting* në përputhje me përcaktimet që përmban shtojca nr. 2 e ligjit nr. 84/2016, si edhe Udhëzimin nr. 4095/2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së. Për pasojë, ky pretendim i subjektit gjendet pa relevancë dhe i pabazuar.

14.12. Në kontekst të parimit të barazisë para ligjit, cenimin e të cilit subjekti e pretendon me referimin në një sërë vendimesh të Komisionit, por edhe të Kolegjit, duke theksuar se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për njësim të standardeve adresohet dhe trajtohet nëpërmjet këtij gjykimi nga Kolegji dhe prezumohet i ezauruar nëpërmjet kontrollit të kryer e të pasqyruar në këtë vendim, trupi gjykues sjell në vëmendje parimin se vlerësimi i subjekteve të rivlerësimit që kanë kryer të njëjtat shkelje duhet të mbështetet në specifikat dhe rrethanat që kanë sjellë shkeljen e kryer, në raport me kuadrin ligjor të identifikuar për zbatim, duke shmangur vlerësime të ndryshme për situata të njëjta, në konsideratë edhe të qëndrimeve të mbajtur nga Gjykata Kushtetuese dhe GjEDNJ-ja sipas së cilave: *[...] Barazia në ligj dhe para ligjit nuk duhet kuptuar se për çështje gjyqësore të pretenduara identike, të ketë zgjidhje të njëjllota nga gjykatat. Mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, sepse çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, e harmonizuar me rrethanat, faktorë, motive apo prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë absolutisht të njëjllota. [...] Barazia në ligj dhe para ligjit nuk ka të bëjë me mënyrën se si është zgjidhur çështja në themel, por me garancitë ligjore, me të drejtat që shteti ka vënë në dispozicion të qytetarëve të tij për zgjidhjen e problemeve të tyre. [...] ¹⁹. [...] një diferencë në trajtimin e personave në situata të ngjashme [...]. Një trajtim i diferencuar është diskriminues nëse nuk ka objektiv dhe arsye të përligjur; me fjalë të tjera, nëse nuk ndjek një synim*

¹⁹ Shih vendimin nr. 71, datë 02.12.1998, të Gjykatës Kushtetuese.

*legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjetit të përdorur dhe synimit të kërkuar për t'u përmbushur [...]*²⁰.

14.13. Lidhur me pretendimin për kontrollin e figurës së saj, mbi shkaqe e rrethana që nuk lidhen me të, pa marrë në konsideratë arritjet e saj profesionale dhe rrethanat lehtësuese, trupi gjykues konstaton se në vlerësimin për këtë kriter, duke mbajtur në konsideratë moskonstatimin e problematikave për subjektin në aspektin profesional, Komisioni ka analizuar rrethanat faktike si të perceptueshme negativisht në syrin e publikut dhe në kundërshtim me pritshmërinë dhe besueshmërinë e tij në figurën publike të një magjistrati, në kontekst të vendimit gjyqësor të formës së prerë që e ka shpallur bashkëshortin e subjektit fajtor për një vepër penale që përfshihet në krimin e organizuar, përcaktuar në nenin 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016. Pretendimet e subjektit për gjykimin apo dënimin për të njëjtin fakt dy herë, një herë penalisht bashkëshorti dhe më pas ajo administrativisht, trupi gjykues i gjen të pabazuara në ligj. Duke abstraguuar në këtë moment analizën mbi drejtësinë e vendimit të Komisionit, lidhur me konkluzionet për kriterin e kontrollit të figurës, analizë e cila do të kryhet në vijim të këtij vendimi, trupi gjykues vlerëson se përpjekja që subjekti bën për të paraqitur procesin administrativ të rivlerësimit si një gjykim të dytë rreth faktit penal dhe sanksionit të vendosur prej tij për bashkëshortin është tërësisht e papërshtatshme dhe nuk gjen mbështetje në asnjë parashikim ligjor. Procesi i rivlerësimit kalimtar si një proces kushtetues i jashtëzakonshëm është parashikuar të përdorë si elementë, të cilët mund të vlerësohen brenda tij, edhe ngjarje që kanë në përbërje fakte penale, të cilat mund të jenë konsumuar prej subjekteve apo personave të lidhur me ta apo edhe vetëm të personave që kanë pasur kontakte me subjektet e rivlerësimit. Parashikimet kushtetuese të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, nenit 3 dhe nenet 33-39 të ligjit nr. 84/2016, demonstrojnë pikërisht këtë parim dhe lejimin e përdorimit të konkluzioneve apo vendimeve të marra në procedime të tjera, penale në këtë rast, si prova që shërbejnë për të kualifikuar dhe konkluduar rreth besueshmërisë së subjekteve në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Pa e parë të nevojshme një shpjegim/analizë të konceptit të gjyimit dy herë për të njëjtin fakt, trupi gjykues çmon se është krejtësisht e qartë se sanksioni penal i përcaktuar për bashkëshortin e subjektit në lëmin penal, nuk mund të konsiderohet se ka ezauruar edhe sanksionet administrative ndaj karrierës së subjektit, të cilat do të përjashtonin zbatimin e ligjit nr. 84/2016, në rastin konkret. Konsekuencat në jetën private, që vijnë për shkak të këtyre dy proceseve që janë autonome dhe zhvillohen mbi parime të ndryshme e kuadër ligjor të ndryshëm, nuk mund të bëjnë të pazbatueshëm kuadrin ligjor të miratuar sipas një vullneti të kushtetutëbërësit, pikërisht për të realizuar këtë penalizim, edhe në planin administrativ, për sa kohë që ai penal shfaqet në lidhje të ngushtë me vijimin e ushtrimit të funksioneve të një magjistrati. Në pikën fundore, trupi gjykues sjell në vëmendje se gjykimi dhe sanksioni penal janë vendosur ndaj personit të lidhur dhe jo subjektit të rivlerësimit, prandaj në mënyrë përfundimtare, nuk mund të mbështet pretendimi i gjyimit dy herë për të njëjtën situatë.

²⁰ Shih Burden k. Mbretërisë së Bashkuar.

14.14. Lidhur me pretendimet për cenim të parimit të ligjshmërisë, subjekti i bazon ato në argumentet se nuk ka një pasuri më të madhe se dyfishi i asaj të ligjshme, se nuk ka kryer fshehje të pasurisë apo për interpretim të gabuar të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, që kërkon plotësimin në mënyrë kumulative që deklarimi i pamjaftueshëm nga ana e subjektit të jetë për të dy kriteret, atë të pasurisë dhe atë të figurës, Kolegji ka arsyetuar gjerësisht e në mënyrë shteruese në jurisprudencën e tij, duke i vlerësuar të pabazuara²¹.

14.15. Në përmbledhje të sa më sipër analizuar në funksion të shkaqeve të ankimit me natyrë procedurale, trupi gjykues vëren se procesi i kryer për subjektin e rivlerësimit në Komision është i rregullt dhe në përputhje me garancitë kushtetuese, ligjore dhe standardet ndërkombëtare të njohura dhe pretendimet ngritura lidhur me to janë të pabazuara.

Shqyrtimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

Pasuria apartament me sipërfaqe 75 m² e ndodhur në Shkodër

15. Në deklaratën e rivlerësimit *vetting*, subjekti deklaron *apartament me sip. 75 m² në adresën: Bulevardi “{***}”, lagjja “{***}”, pallati {***}, kati i {***}, Bashkia Shkodër, blerë në vitin 2004, me çmimin 2.450.000 lekë, me vlerë 2.450.000 lekë, në bashkëpronësi me bashkëshortin, dhe burimi krijimi: blerë me paratë e kursyera nga të ardhurat dhe marrë kredi bankare. Në formularin e deklaratës për detyrimet financiare ndaj personave juridikë e fizikë, subjekti deklaron: huamarrje te Banka e Bashkuar e Shqipërisë [UBA], për blerje apartamenti, Shkodër [adresën përkatëse], me kontratë nr. {***}, datë 22.01.2005, në shumën 2.495.880 lekë, kohëzgjatje 3 vjet 08.03.2005-08.02.2008, në të cilën përfshihet huaja në shumën 2.000.000 lekë dhe interesat 495.880 lekë. Detyrimi i mbetur 0 (zero) lekë.*

15.1. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit *vetting*: (i) akt shitblerje pasurie të paluajtshme, nr. {***}, datë 24.11.2004, të apartamentit me sipërfaqe 75 m², palë blerëse subjekti dhe bashkëshorti, çmimi i shitjes 2.450.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale; si dhe (ii) kontratën e huas nr. {***}, datë 22.01.2005, të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë, huamarrës subjekti dhe bashkëshorti, në shumën 2.000.000 lekë.

15.2. Në deklaratat periodike vjetore të pasurisë [në vijim “DIPP”], për këtë pasuri, subjekti deklaron:

- a) Në DIPP-në 2004: (i) në formularin për deklarimin e pasurive: apartament me sip. 75m², me adresën përkatëse, e hipotekuar, blerë nga S. H., në vlerën 2.450.000 lekë, krijuar më 24.11.2004, në bashkëpronësi me bashkëshortin; (ii) në formularin për detyrimet financiare ndaj personave juridikë e fizikë: *huamarrje 2.000.000 lekë, 3 vjet interesa 495.880 lekë, për të blerë apartamentin, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.01.2005, nr. {***}; detyrim ndaj*

²¹ Shih, ndër të tjerë, vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit: nr. 9/2018 (JR); 7/2019 (JR); nr. 28/2019 (JR); nr. 34/2021 (JR), nr. 23/2022 (JR), nr.19/2019 (JR); nr. 22/2021(JR) dhe nr. 32/2022 (JR).

UBA Bank, Shkodër; shuma e detyrimit e shlyer deri në 31 dhjetor - 0-; shuma e detyrimit të mbetur pa shlyer+ interesa deri në 31 dhjetor 2.495.880 lekë.

- b) Në DIPP-në 2005: (i) në formularin për detyrimet financiare ndaj personave juridikë e fizikë: kredi për blerje banese prej 2.495.880 lekësh, tek UBA, me afat 3-vjeçar, këst mujor 69.330 lekë, nr. i kontratës {***}, shuma e shlyer 911.400 lekë; detyrimin e mbetur pa shlyer 1.584.480 lekë; (ii) në formularin “Të dhëna që nuk publikohen” deklaroi kontratë hipotekimi nr. {***}, datë 22.01.2005, hipotekë e banesës në favor të UBA, dega Shkodër, për kredinë për blerje banese.

16. Në analizë të provave të administruara gjatë hetimit administrativ, fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ, konstatimit se kredia bankare e përfituar rreth dy muaj pas formalizimit në datën 24.11.2004 të kontratës së shitjes së pasurisë²² nuk mund të ketë shërbyer si burim krijimi në datën e nënshkrimit të kontratës, deklarimeve të subjektit në pyetësorë dhe në prapësime, si edhe provave të depozituara në funksion të barrës së provës, lidhur me burimin e deklaruar përgjatë hetimit administrativ - huan 1.500.000 lekë - të padeklaruar në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat periodike të pasurisë, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit: **(i)** nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë në deklaratën *vetting* dhe në deklaratën periodike të kohës; **(ii)** nuk ka arritur të provojë bindshëm burimin e krijimit të shumës së huas; si dhe **(iii)** nuk ka deklaruar kursimet/gjendjen *cash* në vlerën 1.000.000 lekë të disponuara nga bashkëshorti dhe, për pasojë, gjendet në balancë negative në shumën (-) 1.327.330 lekë, për të investuar në blerjen e apartamentit, për të përballuar shpenzimet e tjera familjare dhe arredimin e apartamentit, sipas parashikimeve të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, Komisioni ka çmuar se faktet e dala nga hetimi si dhe në analizë të provave të arsyetuara, në raport me: **(i)** ekzistencën e një kontrate huadhënie të noteruar në kohë reale; **(ii)** qëllimin e marrjes së kredisë, pikërisht për këtë pasuri, por që në fakt

²² ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konstatuar: Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar për apartamentin me sip. 75 m², në Shkodër, blerë me çmim 2.450.000 lekë, sipas kontratës së blerjes nr. {***}, në datën 24.11.2004, ndërkohë që rezulton se kredia është marrë nga banka UBA në vlerën 2.000.000 lekë, në datën 22.1.2005.

Referuar “Kontratë huaje”, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.01.2005, subjekti dhe bashkëshorti P.P., si huamarrës dhe Banka e Bashkuar e Shqipërisë, ndër të tjera, pasqyrohet: [...] Në vijim të letrës së huamarrësit të datës 22.01.2005, BBSH do të jetë e kënaqur të japë edhe një tjetër hua muharaba (“shërbimi”) huamarrësit për të blerë apartament banimi në shumën maksimumi 2.000.000 lekë, me afat shlyerje 3 vjet dhe këst mujor të përcaktuar. [...]. Garanci për huan përcaktohet hipoteka e regjistruar në favor të BBSH mbi pasurinë apartament me sipërfaqe 75 m² dhe adresën përkatëse, pronësi e huamarrësve siç vërtetohet nga certifikata e pronësisë lëshuar nga ZVRPP-ja në datën 02.12.2014.

Me “Kontratë hipotekimi”, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.01.2015, ndër të tjera, pasqyrohet se sipas kontratës së huasë nr. {***}, datë 22.01.2005, është kusht paraparak që përpara dhënies së kredisë, hipotekuesi t’i ketë dhënë përfituesit një hipotekë, dhe me anë të kontratës i jep dhe transferon në hipotekë pronën apartament me sipërfaqe 75 m², të vërtetuar me certifikatën e pronësisë të lëshuar nga ZVRPP-ja Shkodër në datën 02.12.2004.

Kredia e disbursuar në datën 08.02.2005 dhe tërhequr shuma 1.975.000 lekë nga bashkëshorti i subjektit në datën 10.02.2005, është përfituar rreth dy muaj pas formalizimit të kontratës së shitjes së pasurie në datën 24.11.2004.

një pjesë e konsiderueshme shleu huan e padeklaruar, vlerësohen që nuk të vendosin në kushtet e aplikimit të *parimit të proporcionalitetit*, pasi pamjaftueshmëria e deklarimit është e lidhur edhe me dështimin e subjektit në provueshmërinë e elementit tjetër, atë të shpjegimit bindshëm të burimeve të krijimit të kësaj pasurie, që të çmuara në mënyrë kumulative passollën pasojën ligjore të aplikimit të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

17. Subjekti kundërshton si të pabazuara konkluzionet e Komisionit, duke pretenduar se: (i) kjo pasuri, si dhe të tjerat, është deklaruar në deklaraten *vetting* dhe në deklaratat e pasurisë në vite, se për shkak të *gabimeve/pakujdesisë* nuk ka plotësuar drejtë DIPP-të e viteve 2004 dhe 2005, lidhur me burimin e krijimit të pasurisë, por me provat e paraqitura është provuar se veprimi nuk është kryer për të fshehur pasuri apo burim të paligjshëm për krijimin e saj, për rrjedhojë nuk gjen aplikim pika 1 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës; (ii) me shpjegimet dhe provat ka shpjeguar bindshëm krijimin e pasurisë me burime financiare të ligjshme, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, për rrjedhojë nuk gjen aplikim pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës; (iii) rezulton e provuar se ka plotësuar dhe dorëzuar në kohë deklaratat e pasurisë se nuk ka fshehur apo paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, për rrjedhojë aplikimi i pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës është abuziv dhe i pambështetur në të dhënat faktike, në prova e ligj.
18. Trupi gjykues, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pasi analizoi të gjithë shkaqet e ankimit dhe kërkimet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në ankim dhe në parashtrime, në funksion të kontrollit të konkluzionit të Komisionit, për pasurinë “Apartament”, me sipërfaqe 75 m², në Shkodër, blerë në vitin 2004, me çmimin 2.450.000 lekë, në bashkëpronësi me bashkëshortin, bazuar në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaraten e pasurisë *vetting*, në deklaraten periodike të pasurisë të vitit 2004 dhe në deklaratat vijuese, duke qenë se nuk ka deklaruar në to huan e pretenduar si një nga burimet e krijimit të kësaj pasurie, siç kuadri ligjor në fuqi e detyronte. Gjithashtu, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie, pasi nuk arriti të provojë bindshëm ekzistencën e marrëdhënies së huas me shtetasit Xh. e L. Th. dhe në versionin garantist se ajo ka ekzistuar, as krijimin e saj me burime të ligjshme. Për rrjedhojë, nga kontrolli që i bëhet vendimit të Komisionit, konfirmohet konkluzioni i arritur prej tij se subjekti gjendet në kushtet e parashikuara në germa “a” dhe “b”, të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Në vijim, analiza dhe vlerësimi i trupit gjykues.
19. *Lidhur me konkluzionin e Komisionit se nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht burimin e ligjshëm në deklaraten vetting dhe në deklaraten periodike të kohës.*

19.1. Lidhur me mosdeklarimin në DIPP dhe në deklaraten *vetting* të huas së marrë nga shtetasit Xh. dhe L. Th., subjekti pretendon se është rrjedhojë e perceptimit dhe e moskonsiderimit të huas si burim i blerjes së pasurisë/burim parësor i blerjes së pasurisë, për sa burim fundor dhe real është kredia bankare, gabim që e ka pranuar gjatë hetimit administrativ. Sipas subjektit, me përpjekjen për korrigjim përmes deklarimit me vetiniciativë të huas me përgjigjet e pyetësorit në fillim të

procesit të rivlerësimit, është një tjetër tregues i mirëbesimit të saj në deklarin e kësaj pasurie, si edhe i dëshirës për riparim të gabimit të bërë. Duke pretenduar që rezulton e provuar plotësisht se mosdeklarimi ka ardhur si pasojë e gabimit njerëzor, se nuk ekzistojnë elemente keqbesimi në deklarin e burimeve të krijimit të pasurisë, subjekti kërkon që shkaqet për të cilat ka ndodhur ky gabim, Kolegji t'i çmojë dhe t'i vlerësojë në unitet, bazuar në parimet e barazisë, objektivitetit, humanizmit dhe proporcionalitetit dhe, në këto kushte, mosdeklarimi i huas të cilësohet vetëm si pasaktësi në deklarin, e cila nuk mund të përbëjë shkak për shkarkimin e saj nga detyra.

19.2. Subjekti rendit rrethanat për shkak të të cilave ka ndodhur ky gabimin, duke potencuar si vijon:

(i) Për shkak të mosnjohjes korrekte të ligjit nr. 9049/2003, mënyrës formale të plotësimit të formularit të pasurisë, të plotësimit dhe dorëzimit të DIPP-së për vitin 2004, në mars të vitit 2005, për shkak se si burim i krijimit të pasurisë është deklaruar kredia bankare e marrë në shkurt të vitit 2005 dhe nuk është deklaruar huaja e marrë me aktin “Kontratë huadhënie”, me nr. {***} rep., datë 23.11.2004, lidhur përpara noteres, një ditë përpara blerjes së banesës, në vlerën 1.500.000 lekë, e cila ishte e shlyer në momentin e plotësimit të DIPP-së të vitit 2004. Duke pasur në konsideratë datën e dorëzimit të deklaratës, 31 mars të vitit pasardhës, në DIPP-në 2004 është ngatërruar dhe ka deklaruar kredinë bankare të marrë në shkurt 2005, ndërsa në DIPP-në 2005, kur duhet të deklarohej kredia bankare, ka deklaruar vetëm shlyerjen e kredisë dhe detyrimin e mbetur. Subjekti kërkon vlerësimin e këtij gabimi në kontekst të faktit se në deklarinet e para të pasurisë në vitin 2004 janë bërë gabime thuajse nga të gjithë subjektet deklaruese, të kohës së shkurtër të mbajtjes së shumës së huas, si edhe qëllimit të marrjes së saj për fitimin e pronësisë së apartamentit, me qëllim për ta lënë si garanci hipotekore për kredinë bankare.

(ii) Mosdeklarimi në deklaratën *vetting* i huas si burim krijimi i pasurisë ka ardhur si pasojë e gabimeve “zinxhir” në DIPP-në 2004 dhe në DIPP-në 2005, si dhe të faktit se nga ILDKPKI-ja nuk i është vënë në dukje pasaktësia, edhe pse në vitin 2016 është pyetur mbi burimin e blerjes së apartamentit dhe, për këtë arsye, ka menduar se deklarimi është i saktë.

19.3. Nga aktet në fashikuj, lidhur me deklarin e huas prej 1.500.000 lekësh si burim krijimi të pasurisë “Apartament”, konstatohet se:

(i) *Me përgjigjet e pyetësorit nr. 1²³*, subjekti, ndër të tjera, bën të njëjtat deklarime sikundër në parashtrimet e ankimit. Konkretisht, në datën 23.11.2004, i është marrë hua shuma 1.500.000 lekë hallës, L. Th. dhe bashkëshortit të saj, Xh. (Xh.) Th., për efekt të blerjes së banesës në qytetin e Shkodrës, e formalizuar me një dokument noterial “Kontratë huadhënie”, numër {***} rep., datë

²³ Për pyetjen nr. 19, “A keni marrë ndonjëherë ndonjë borxh nga ndonjë person apo shoqëri private? Nëse po, lutemi shënoni shumën, datën, marrëdhënien me huadhënësin, kushtet e shlyerjes dhe gjendjen e shlyerjes. Ju lutem sillni dokumentacion provues për të gjitha këto. Ju lutem sillni dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit.”

23.11.2004, shumë e përdorur në datën 24.11.2004, për të blerë apartamentin. Meqenëse banka nuk e financonte drejtpërdrejt blerjen e apartamentit, por u premtua që me paraqitje të dokumentit të pronësisë, bazuar në të ardhurat nga paga si prokuror, kredia do të jepej maksimumi në vlerën 2.000.000 lekë, ishin të detyruar të merrnin këtë shumë hua për një periudhë të shkurtër kohore, sa të bëhej kalimi i pronësisë së apartamentit dhe hipotekimi, për llogari të bankës. Nga huadhënësit i është thënë se kjo shumë është *marrë nga banka, duke prishur interesin e depozitës* dhe, për këtë arsye, kanë përpiluar një kontratë huadhënie me interes, në mënyrë që huadhënësit të mos dëmtoheshin nga prishja e depozitës. Huaja është marrë me afat shlyerje 1 vit, me interes, por meqenëse është kthyer pas tre muajve, huadhënësit nuk i kanë marrë asnjë lloj interesi. Për kthimin e huas nuk kanë mbajtur akt me shkrim në kohë, pasi nuk mendonin se do të kishin probleme për shkak të marrëdhënieve familjare, por e kanë formalizuar me aktin noterial “Deklaratë noteriale e datës 27.12.2019”, me autentifikim nënshkrimi në prani të noterit, me nr. {***} rep., datë 28.12.2019. Deklarata noteriale e vitit 2004, e shënuar në regjistrin noterial të noterit të vitit 2004, disponimi i kopjeve të saj nga palët dhe noterja, pasqyrojnë më së miri faktin se ky veprim ka ndodhur në vitin 2004. Bashkëlidhur përgjigjeve, subjekti ka depozituar kopje të vërtetuar me origjinalin nga notere L. H., me nr. rep. {***}, datë 27.12.2019, të “Kontratë huadhënie nr. {***} rep., datë 23.11.2004”.

(ii) *Me përgjigjet e pyetësorit nr. 2*, lidhur me kërkesën e Komisionit për të deklaruar dhe depozituar dokumentacion provues mbi mënyrën si është marrë shuma prej 1.500.000 lekësh nga huadhënësit (*cash/dorazi* apo me bankë), si dhe mbi mënyrën e shlyerjes së këtij detyrimi, subjekti deklaroi se marrja e shumës së huas është bërë *cash/dorazi* dhe jo me bankë, dhe se për kthimin e saj, pas lëvrimit të kredisë nga banka, në datën 08.02.2005, nuk kanë mbajtur akt me shkrim në atë kohë, pasi për shkak të marrëdhënieve familjare nuk mendonin se mund të kishin probleme me huadhënësit. Kthimi i shumës së huas evidentohet edhe nga llogaria bankare e L. Th., ku pas datës 08.02.2005 ka depozitime vlerash monetare prej saj, specifikisht në datën 29.02.2005 është depozituar shuma 500.000 lekë dhe në datën 29.04.2005 është depozituar shuma 1.500.000 lekë.

19.4. Trupi gjykues analizoi pretendimet e subjektit në raport me faktet që kanë rezultuar nga hetimi që u përshkruan më sipër, duke i vlerësuar ato në harmoni me njëra-tjetrën dhe nën dritën e kuadrit ligjor në fuqi. *Së pari*, detyrimet e buruara nga kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit për plotësimin me korrektësi dhe në mënyrë të detajuar të deklaratës *vetting* dhe paraqitjen e të gjitha dokumenteve që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, përjashtojnë pretendimin që mosdeklarimi i huas si burim krijimi i pasurisë të jetë pasojë e gabimeve në deklaratat e pasurisë të dorëzuara pranë ILDKPKI-së. Konkretisht, nën dritën e parashikimit në nenin D të Aneksit të Kushtetutës - *subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë, në përputhje me ligjin* - ligji nr. 84/2016, në nenin 32, “Deklarimi i pasurisë”, parashikon se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Në ndihmë të subjekteve deklaruuese të këtij procesi, për qartësimin e parashikimeve kushtetuese dhe ligjore në nivel zbatimi, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së ka nxjerrë Udhëzimin nr. 4095/2016, i cili, në pikën 7, parashikon se për çdo pasuri

në pronësi të paluajtshme, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të duhet të deklarojnë burimin, *në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre.* Në këtë situatë ligjore dhe faktike, kur sipas vetëshpjegimeve të subjektit me huan është bërë pagesa dhe fitimi i pronësisë së apartamentit, që ka mundësuar përdorimin e tij si kolateral për të përfituar në vijim kredinë bankare, pretendimi se huaja ka shërbyer si mjet formal për krijimin e kësaj pasurie, nuk është i besueshëm, por as i logjikshëm, përderisa nga shpjegimet e vetë subjektit ajo dëshmohej të ketë qenë burimi real i krijimit të pasurisë, e për pasojë, në deklaratën *vetting* huaja duhet të ishte deklaruar si e tillë. *Së dyti*, në referim të nenit 31 të ligjit nr. 84/2016, që parashikon fillimin e procedurës së vlerësimit të pasurisë me plotësimin e deklaratës së pasurisë sipas shtojcës 2 të ligjit, të quajtur deklarata *vetting* në këtë proces të vlerësimit kalimtar, pretendimet për mosdeklarimin e huas si burim krijimi i pasurisë, *me mendimin se deklarimi i pasurisë në DIPP-në 2004 është i saktë për sa nga ILDKPKI-ja nuk i është kërkuar të japë shpjegime për pasaktësi*, përpos i pakuptimtë, vlerësohet i pabazuar. Referuar nenit 179/b të Kushtetutës, pikës 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, kryerja e procedurave të rivlerësimit, me objekt hetimin dhe vlerësimin e pasurisë së subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit në deklaratën *vetting* dhe ato periodike. Nën dritën e këtij kuadri ligjor, subjektet e rivlerësimit që dëshirojnë të jenë pjesë e sistemit të drejtësisë, deklarojnë nën përgjegjësi pasuritë në pronësi e përdorim të tyre dhe burimin e krijimit, sikurse edhe duhet të shpjegojnë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre pasurive, si edhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

19.5. Trupi gjykues, gjithashtu, vlerëson të pabazuara pretendimet e subjektit për mosdeklarim të huas në deklaratat e pasurisë në vite, qoftë si burim për krijimin e pasurisë, qoftë si detyrim ndaj huadhënësve. Shkaqet e parashtruara prej subjektit - *mosnjohja e drejtë të ligjit, mënyra formale e plotësimit të formularit të pasurisë, ngatërresa të ardhura si pasojë e dorëzimit të deklaratës në datën 31 mars të vitit pasardhës, kohës së shkurtër të mbajtjes së huas dhe qëllimit të marrjes së saj për fitimin e pronësisë së apartamentit për ta lënë si kolateral* - nuk gjejnë bazueshmëri në ligjin nr. 9049/2003, përderisa në të parashikohen qartë detyrimet për subjektet deklaruuese, të qartësuara edhe në formularët e deklarimit të pasurisë të kohës. Konkretisht, ligji i kohës nr. 9049/2003, në nenin 4, “Afati dhe objekti i deklarimit”, parashikonte detyrimin e subjekteve deklaruuese për deklarim *brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare*, dhe në deklaratë, në formularin për deklarimin e pasurive qartësohej *detyrimi për deklarim vjetor/ pasqyrim të pasurive të paluajtshme të ndodhura brenda ose jashtë Shqipërisë deri në 31 dhjetor të vitit paraardhës*. Në DIPP-në 2004, subjekti nuk deklaroi burimin e krijimit të pasurisë “Apartament”, pavarësisht detyrimit të buruar nga neni 21 i ligjit të sipërcituar, se *deklarimi përfshin pasurinë dhe burimet e krijimit të saj*, dhe pasqyrimin në formular, *përshkrimi i hollësishëm i çdo pasurie (lexo nenin 21 të ligjit)*. Në vijim, në formularin për detyrimet financiare ndaj personave juridikë gjendet rubrika e deklarimit të detyrimeve financiare, si kërkesë e nenit 4 të ligjit, që do të

ndihmonte në argumentimin e drejtë të pasurisë së vënë ndër vite apo gjatë vitit, në të cilën duhet të renditen të gjitha detyrimet financiare (kredi, hua, borxh) që kanë shërbyer për të krijuar pasuri të ndryshme të paluajtshme apo të luajtshme, të tregohet shkaku i marrjes, shuma e marrë, kohëzgjatja dhe personi huadhënës. Sa më sipër, në DIPP-në 2004, mosdeklarimi i huas së marrë nga bashkëshortët Th., as si burim i krijimit të pasurisë dhe as si detyrim, aq më tepër kur sipas aktit të paraqitur, detyrimi përfaqësonte, jo vetëm kthimin e shumës së huas, por edhe interes vjetor 7% apo të llogaritur deri në momentin e shlyerjes, nuk vlerësohen si gabime për shkak të deklarimeve për herë të parë të pasurisë nga subjekte njohës dhe zbatues të ligjit. Vlen të evidentohet se, sipas pretendimeve të subjektit, huaja e marrë në nëntor të vitit 2004, është shlyer në shkurt të vitit 2005, pra, ndonëse ajo konsiderohet si një hua afatshkurtër ka qenë në fuqi të fund të vitit 2004, për pasojë e deklarueshme edhe si burim për krijimin e pasurisë “Apartament”, por edhe si detyrim financiar ndaj individëve. Gabimet në deklarime që subjekti pretendon se ka kryer në DIPP-në e vitit 2004, në të cilën ka deklaruar edhe kredinë e marrë në shkurt të vitit 2005, nuk justifikojnë mosdeklarimin e huas në vitin 2004 thjesht si një gabim njerëzor i kuptimit të mënyrës për deklarim, për sa kohë që ky gabim njerëzor nuk është ndrequr të paktën në deklaratën *vetting*, kur ligji thirri subjektet për deklarim nën përgjegjësi. Mungesa e deklarimit në deklaratën *vetting* dhe në deklarata periodike, sipas bindjes së trupit gjykues, vë në dyshim vetë ekzistencës e kësaj marrëdhënie, dyshim i cili do të analizohet më tej edhe në këndvështrim të një analize të detajuar të akteve që janë administruar gjatë hetimit në Komision. Një situatë e tillë, minimalisht nuk zhbën kualifikimin e saj sipas nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, siç me të drejtë ka vepruar edhe Komisioni.

19.6. Lidhur me pretendimin se nga ILDKPKI-ja nuk i është kërkuar asnjëherë dhënia e shpjegimeve për pasaktësi në plotësimin e deklaratës së pasurisë, edhe pse është pyetur në vitin 2016 mbi burimin e përdorur për blerjen e apartamentit, trupi gjykues, *së pari*, konstaton se nga inspektorët e ILDKPKI-së subjekti është pyetur se çfarë është lënë kolateral për kredinë në vlerën 2.000.000 lekë, të marrë në Bankën e Bashkuar të Shqipërisë Sh.A, me qëllim blerjen e apartamentit, të deklaruar në DIPP-në 2004. *Së dyti*, fakte të lëna në heshtje nga ILDKPKI-ja, sikundër në këtë rast, duke mos kërkuar shpjegime për mosdeklarimin e burimit të krijimit të apartamentit, nuk mund të pretendohen si ndikuese në plotësimin e deklaratës *vetting*, si dokumenti bazë prej nga fillon procedura e rivlerësimit kalimtar.

19.7. Lidhur me pretendimin për mospasje të qëllimit për të fshehur huan, e cila është marrë me akt *noterial të datës 23.11.2004*, dhe se në vendim nuk pasqyrohet çfarë ka rezultuar nga veprimi hetimor i kryer pranë noteres L.H., me qëllim verifikimin e vërtetësisë së deklaratës *noteriale të datës 23.11.2004 (aktit të huadhënies)*, trupi gjykues konstaton dhe analizon si vijon:

19.8. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision “Kontratë huadhënie” të datës 23.11.2004, nënshkruar dhe vulosur nga notere L. H., kopje të njësuar me origjinalin nga po kjo notere me nr. {***} rep., datë 27.12.2019. Në kontratën e huadhënies, të shtypshkruar, në krye me shkrim dore pasqyrohet “nr. {***}”. Në aktin “vërtetim i njësisë me origjinalin”, pasqyrohet se në Zyrën e

Noterisë është paraqitur shtetasi P. P., i cili ka kërkuar vërtetimin me origjinalin të dokumentit të fotokopjuar bashkëlidhur: Kontratë huadhënie nr. rep. {***}, datë 23.11.2004. Noterja, pas krahasimit të përmbajtjes së dokumentit të fotokopjuar me origjinalin e paraqitur dhe pasi konstaton se është nxjerrë nga dokumenti origjinal dhe në të nuk ka fshirje, korrigjime, shtesa dhe shenja të tjera të veçanta, vërteton se fotokopja është e njëjtë me dokumentin e paraqitur.

19.9. Në aktin “Kontratë huadhënie” pasqyrohet se: *kontrata është përpiluar në Shkodër, sot më datë 23.11.2004, mes palëve: huadhënës Xh. dhe L. Th., huamarrës Ajola Y. e P. P. [për secilin prej këtyre shtetasve pasqyrohen të dhënat personale, vendbanimi dhe numri i dokumentit të identifikimit]; objekti i kontratës: dhënia hua e një shume prej 1.500.000 lekësh; afati i kontratës 1 vit; interesi: 7% në vit; përmbajtja: në bazë të kësaj kontrate huadhënësit i japin huamarrësve një hua në vlerën 1.500.000 lekë; qëllimi i kësaj kontrate është blerja e një banese që ndodhet në adresën: ... (e paplotësuar). Huaja jepet për një periudhë kohore 1 vit, me interes vjetor 7% dhe, në përfundim të afatit të kontratës, huamarrësit do t’u paguajnë huadhënësve shumën 1.605.000 lekë, që përfshin huan me interesat përkatëse. Në rast të kthimit më përpara të huas, interesi do të llogaritet deri në momentin e shlyerjes. Si mjet për garantimin e huas është banesa që do të blihet, për blerjen e së cilës jepet huaja në fjalë. Në rast se nga ana e huamarrësve nuk bëhet ekzekutimi në të holla, huaja + interesi, brenda afatit të kontratës, huadhënësit kanë të drejtë të kërkojnë që ekzekutimi i detyrimit të bëhet me banesën e vënë si mjet garancie. Kontrata përmbillet me “Kjo kontratë përpilohet në tre kopje, ku një kopje i jepet huadhënësve, një kopje huamarrësve, dhe një kopje noteri”.*

19.10. Referuar procesverbalit të mbajtur nga Komisioni, në Shkodër, në datën 27.10.2021, në zyrën e noteres publike L. H., “Për verifikimin e kontratës së huadhënies, datë 23.11.2004”²⁴, trupi gjykues konstaton disa të dhëna që vlerësohen se duhen evidentuar dhe mbajtur në konsideratë për vlerësimin e besueshmërisë së këtij akti si vijon:

(i) Kontrata e huadhënies, datë 23.11.2004, objekt verifikimi, rezulton të jetë përpiluar si një akt privat midis palëve, Xh. Th. dhe L. Th. si huadhënës dhe P. P. dhe Ajola Y. si huamarrës, në një format prej një flete me përmbajtje të plotë në faqen e parë dhe vetëm katër reshta në faqen e dytë. Në përmbajtjen e saj nuk evidentohen se ajo është redaktuar prej noteres publike dhe as se është kryer ndonjë deklaram para saj, madje as evidentohet se palët janë paraqitur para noteres për vërtetimin e nënshkrimeve të tyre në një akt privat. Në paragrafin e fundit të kontratës, shkruhet se: *kjo kontratë përpilohet në tre kopje, ku një kopje i jepet huadhënësve, një kopje huamarrësve dhe një kopje noteri.* Pas këtij përcaktimi, kontrata është e nënshkruar prej palëve dhe pas tyre gjendet shënimi “Notere L. S. H.” dhe nënshkrimi i noteres nën emrin e saj. Në krye të faqes së parë, në anën e djathtë të saj, ka një shënim me shkrim dore, “NR. {***}”.

²⁴ Bashkëlidhur procesverbalit, i nënshkruar edhe prej noteres, është vërtetimi i datës 27.10.2021, i noteres L. H., nënshkruar dhe vulosur prej saj, përmes së cilit vërtetohet se janë nxjerrë nga arkiva e zyrës në formën origjinale, u fotokopjuan, u vulosën prej saj dhe i vihen në dispozicion Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dokumentacioni: (i) kontratë e huapërdorjes nr. rep. {***}, datë 23.11.2004; (ii) deklaratë nr. rep. {***}, datë 21.12.2004; (iii) deklaratë nr. rep. {***}, datë 21.12.2004.

(ii) Të dhënat e mësipërme tregojnë se akti kontratë huadhënie nuk është redaktuar nga noteria, por se duket se palët kanë synuar legalizimin e nënshkrimeve të tyre tek ajo. Në këndvështrim të nenit 55 të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994, “Për noterinë”, i ndryshuar, në fuqi në kohën e kryerjes së këtij veprimi, parashikonte se: *Vërtetimi i nënshkrimeve bëhet për akte private që nuk përmbajnë lidhjen e një kontrate ose kryerjen e një veprimi tjetër juridik. Vërtetimi bëhet në fund të aktit, pas nënshkrimeve, duke u bërë shënimi nga noteri se personat u paraqitën personalisht dhe nënshkruan në prani të tij ose pranuan se nënshkrimet janë të tyre.* Nga këqyrja e aktit objekt verifikimi rezulton se asnjë prej elementeve të detyrueshme për të qenë pjesë e aktit apo e veprimeve noteriale të detyrueshme për t’u kryer, nuk pasqyrohet të ketë ndodhur.

(iii) Noterja është pyetur mbi formën e aktit, i cili ndonëse titullohet *kontratë huadhënie*, nuk rezulton nga përmbajtja të jetë hartuar nga noteria, se përse nuk është bërë legalizimi i nënshkrimit sipas ligjit. Noterja ka deklaruar se: *nuk gjej shpjegim për të dhe se është bërë me kompjuter, nuk është hartuar prej saj dhe firma në fagen e dytë është e saj.*

(iv) Në arkivin e noteres, prej Komisionit, janë administruar edhe tri dokumente të tjera noteriale, një akt noterial, kontratë shitblerjeje dhe dy veprime noteriale të autentifikimit të nënshkrimeve, të dy deklaratave të individëve, të përpiluara në të njëjtën periudhë me kontratën e huadhënies, të cilat rezultojnë të jenë hartuar në përputhje me elementet e formës të parashikuar prej ligjit, ndryshe nga akti objekt verifikimi.

(v) Nga krahasimi i aktit të nxjerrë nga arkiva e noteres me atë që dispononte Komisioni dhe të dorëzuar prej subjektit, vërehet se në kopjen e Komisionit, shtetasi Xh. Th. ka shkruar emrin dhe mbiemrin, ndërsa në kopjen e disponuar nga noterja vërehet se poshtë emrit ka vetëm një nënshkrim; sa i takon shtetases L. Th., vërehet se në kopjen që disponon noterja, emri dhe mbiemri i saj është shkruar me dorë, por nuk ka firmë të saj, ndërsa në kopjen e disponuar nga Komisioni ka emër, mbiemër dhe firmë të saj.

(vi) Veprimi noterial rezulton në dukje të ishte i reflektuar në regjistrin e veprimeve noteriale të vitit 2004 dhe, në fletën e regjistrit që shënohen veprimet e kryera, në numrin e repertorit vërehet një korrigjim i pashpjegueshëm në numrat, nga {***} në {***}, korrigjim që vërehet edhe në numrat e tjerë paraardhës dhe pasardhës.

19.11. Në referim të të dhënave të përmendura më lart, trupi gjykues konstaton defekte të rëndësishme në aktin e titulluar kontratë huadhënie dhe rrethana që vënë në dyshim autentifikimin e nënshkrimit prej noteres, pikërisht në kohën e shënuar se është përpiluar edhe kontrata. Mungesa e veprimtarisë së noterit publik sipas përcaktimeve ligjore, të cilat duhen kryer pikërisht për t’i dhënë aktit vlerën e një dokumenti të certifikuar për disa elemente, si koha dhe nënshkrimi prej individëve të përmendur si hartues të aktit, prej zyrtarit publik dhe, për pasojë, edhe një vlerë provuese të posaçme, zbeh fuqinë e tij provuese. Mungesat e konstatuara, qoftë lidhur me të dhënat e kontratës dhe numërtimin që ajo ka marrë në regjistrat noteriale apo mospasqyrimi i veprimeve të detyrueshme në kuptim të ligjit, si verifikimi i identitetit të palëve, i zotësisë juridike dhe i zotësisë për të vepruar, si dhe mospërputhshmëria e konstatuar lidhur me nënshkrimet e huadhënësve [kopjen e paraqitur prej subjektit dhe në kopjen e noteres], ndërkohë që

rregullshmëria e nënshkrimeve prezumohet e garantuar prej noterit²⁵, pasjellin që nënshkrimi dhe vula e noteres të mos prezantojnë atë çfarë ligji prezumon të vërtetohet përmes tyre, me pasojë lindjen e dyshimeve të arsyeshme për vërtetësinë e ekzistencës së marrëdhënies së huas.

19.12. Për sa më sipër, në konsideratë edhe të mungesës së deklarimeve të subjektit për përdorimin e huas si një burim për krijimin e pasurisë si më lart arsyetuar, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm ekzistencën e marrëdhënies së huas me shtetasit Xh. dhe L. Th. në vitin 2004. Për pasojë, ajo nuk mund të konsiderohet si burim për krijimin e pasurisë.

20. *Lidhur me konkluzionin e Komisionit se nuk ka arritur të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të shumës së marrë hua*

20.1. Subjekti e kundërshton këtë konkluzion me pretendimin se është rrjedhojë e konstatimit jo të plotë dhe të drejtë të situatës faktike lidhur me burimet e huadhënësve Xh. e L. Th.. Në ankim, subjekti parashtron se të ardhurat e huadhënësve janë nga burime të renditura si vijon: (i) ushtrimi i aktivitetit tregtar të shitjes së fruta-perimeve me shumicë dhe pakicë nga bashkëshorti i hallës, i regjistruar nën përgjegjësinë tatimore “Biznes i vogël”, me kod fiskal {***}, me vendimin nr. {***}, datë 01.03.2000, të gjykatës. Volumi i të ardhurave për periudhën 2000 - 2004 nga ky aktivitet, pavarësisht përpjekjeve të saj, nuk mund të provohet për shkaqe objektive [dokumentacioni i periudhës përpara vitit 2005 është asgjësuar apo ka humbur për faj të institucioneve shtetërore, huadhënësit nuk kanë pasur detyrim për ruajtjen e tij], por nga aktet shkresore rezultojnë të dhëna për rritjen e volumit të të ardhurave nga kjo veprimtari. Prej saj nuk është kërkuar që këto të ardhura të njihen si i vetmi burim i ligjshëm i krijimit të huas, por minimalisht është kërkuar që të njihet fakti se të ardhurat e realizuara nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit të hallës, të paktën janë të barabarta me shpenzimet e jetesës së familjes së tyre; (ii) shfrytëzimi i tokave të fituara me ligjin nr. 7501, me sipërfaqe 9000 m², nga të cilat 8700 m² tokë arë, për prodhimin e produkteve bujqësore, të përdorura për konsum vetjak dhe për shitje gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare nga bashkëshorti i hallës. Edhe nëse prej saj nuk mund të provohet vlera e të ardhurave nga kjo veprimtari apo fakti se të ardhurat e siguruar nga veprimtaria bujqësore-tregtare kanë qenë burim i huas, provohet minimalisht se me to huadhënësit kanë mbuluar shpenzimet për jetesë, duke i mundur kursimin e të ardhurave nga shitja e tokës; (iii) shitja e tokës: në datën 23.07.1999, shitja e sipërfaqes 1500 m² në vlerën 500.000 lekë, bashkë me bashkëpronarët e tjerë; në datën 27.12.2001, shitja e sipërfaqes 1668 m² në vlerën 1.751.400 lekë [sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme me nr. {***}, ndodhur në ZK {***}, fshati {***}, Shkodër, vërtetohet ndryshimi i pronësisë nga bashkëshorti i hallës, Xh. C. Th., te shtetasi A. B. P.], të ardhura të ligjshme për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Bazuar në qëndrimin e Kolegjit²⁶, subjekti potencon se shuma e të ardhurave e përfutur nga huadhënësit në datën

²⁵ Ligji nr. 7829, datë 01.06.1994, “Për noterinë”, parashikon: “Aktet nënshkruhen rregullisht nga palët dhe nga pjesëmarrësit në akt në prani të noterit, duke shkruar emrin dhe mbiemrin e plotë”.

²⁶ Subjekti citon vendimin e Kolegjit nr. 15, datë 17.07.2019: “[...] se në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e

21.12.2001, në vlerën 1.751.400 lekë, tejkalon shumën e huas të dhënë tri vite më vonë prej 1.500.000 lekësh dhe mjafton për të vlerësuar si të ligjshëm *burimin e të ardhurave që më dhanë hua*, përderisa nuk provohet që gjatë kësaj periudhe trevjeçare huadhënësit të kenë kryer ndonjë investim që cenon këto të ardhura.

20.2. Komisioni ka vlerësuar se në analizë të fakteve të dala nga hetimi, subjekti ka dështuar të shpjegojë bindshëm burimin e krijimit të shumës së marrë hua dhe, për pasojë, burimin e krijimit të kësaj pasurie, duke arsyetuar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

(i) Në deklaratën noteriale, datë 27.12.2019, *me autentifikim nënshkrimi, në prani të noterit, me nr. {***} rep., datë 28.12.2019*, të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, huadhënësit, nën përgjegjësinë e tyre ligjore dhe me vullnet të lirë, kanë deklaruar lidhur me vërtetësinë e burimeve të tyre për krijimin e shumës së dhënë hua se ajo përbëhet nga të ardhurat e tyre nga biznesi dhe se këto i kanë pasur përkatësisht në vlerën 1.000.000 lekë, në llogarinë bankare në Bankën Kombëtare Tregtare, të cilat i kanë tërhequr dhe vlerën 500.000 lekë e kanë pasur në banesë, ndërsa subjekti gjatë hetimit administrativ ka deklaruar se huadhënësit i kanë thënë se si burim kanë shërbyer edhe të ardhurat e përfituara nga shitja e tokës.

(ii) Duke iu referuar deklaratimit të huadhënësve, në analizë të dokumentacionit të depozituar nga subjekti, nuk provohet ligjshmëria e të ardhurave nga aktiviteti privat i huadhënësit, pasi informacioni i dërguar nga institucionet tatimore provon ekzistencën e dokumentacionit certifikues të ushtrimit të biznesit, por jo qarkullimin apo të ardhura të fituara. Duke mos mohuar ushtrimin apo kryerjen e aktivitetit privat nga huadhënësit, krijimin dhe fitimin e të ardhurave prej tyre, në raport me kërkesat ligjore për provueshmërinë e burimit të ligjshëm, pretendimet e huadhënësve, për rrjedhojë edhe të subjektit mbeten vetëm në nivel deklarativ.

(iii) Edhe nga verifikimi i transaksioneve bankare rezultoi se nga shuma 1.000.000 lekë, prej huadhënësve ishin tërhequr vetëm 500.000 lekë dhe jo e gjithë shuma, sikundër deklarohet në deklaratën noteriale. Ky konstatim krijon një pamjaftueshmëri në vetvete të provueshmërisë së krijimit të shumës 1.500.000 lekë, pasi shuma e tërhequr prej 500.000 lekësh së bashku me shumën 500.000 lekë, të pretenduar nga huadhënësit *se ishte në banesë*, nuk formojnë në tërësi shumën e dhënë hua.

(iv) Lidhur me ligjshmërinë e shumës së dhënë hua, Komisioni nuk ka vlerësuar kryerjen e përlllogaritjeve përpara vitit 2000, për shkak se këtë vit, huadhënësit kishin shpenzuar një shumë të konsiderueshme prej 1.500.000 lekësh, për të blerë automjetin tip fugon, në interes të biznesit të tyre.

(v) Në raport me pretendimin e subjektit se huadhënësit janë shprehur se huaja ka pasur si burim krijimi edhe të ardhurat nga shitja e pasurisë në vitin 2001, në shumën 1.751.400 lekë, vlerë e cila konfirmohet ligjërisht me kartelën përkatëse të pasurisë, Komisioni ka çmuar se e vetmja shumë që *a priori* mund të konsiderohet me këtë burim do të ishte shuma prej 500.000 lekësh, e deklaruar se mbahej në banesë në kohën e dhënies së huas. Duke konsideruar faktin e pakontestueshëm të

burimit të krijimit të kësaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur [...]”.

transaksionit bankar përpara dhënies së huas - tërheqjes së shumës 500.000 lekë dhe jo 1.000.000 lekë, sikundër kanë deklaruar huadhënësit në deklaratën noteriale - Komisioni ka vlerësuar se, edhe në variantin e prezantuar prej subjektit, përsëri nuk provohet mjaftueshmëria e burimeve të ligjshme për krijimin e shumës së huas, vlerësim që përforcohet edhe me mospërputhjet e deklaramit të subjektit se huadhënësit i kanë thënë se si burim krijimi janë edhe të ardhurat nga shitja e pasurisë, me deklarimin noterial të huadhënësve se burimi i krijimit të shumës së huas janë të ardhurat e tyre nga biznesi.

20.3. Nga të dhënat që kanë rezultuar prej akteve në fashikuj, trupi gjykues vëren se subjekti ka qenë inkohorent në pretendime lidhur me burimin e krijimit të huas, në përpjekje për të paraqitur faktet në favor të situatës së saj, përpjekje të cilat i dëshmon edhe në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, me pretendimin për të konsideruar edhe ardhura të tjera të huadhënësve në vitin 2000, të papretenduara në Komision dhe në ankim. Konkretisht, me pyetësorin e datës 15.05.2020, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën e huadhënësve të datës 27.12.2019, *lëshuar sipas kërkesës së të interesuarës Ajola Prençi për ta përdorur ku t'i nevojitet, ku me përgjegjësi të plotë ligjore* ata deklarojnë se shuma e huas është krijuar në vite si rezultat i aktivitetit tregtar të shitblerjes së fruta-perimeve me shumicë dhe pakicë, që nga viti 1992 e në vijim. Në përgjigjet e këtij pyetësi, subjekti deklaroi se huadhënësit ndër vite kanë pasur të ardhura nga aktiviteti i shitjes së fruta-perimeve nga Xh. Th., që pasqyrohet edhe në depozitat bankare të familjes në vite, për të cilat ka paraqitur dhe dokumentacion justifikues. Gjithashtu, në këto përgjigje subjekti shpjegon se nga huadhënësit *i është thënë* se një pjesë e të ardhurave të tyre është dhe nga shitja e tokës arë, të fituar në bazë të ligjit nr. 7501, por për to nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues. Me pyetësorin vijues të datës 20.06.2020, lidhur me kërkesën e Komisionit për të depozituar dokumentacion justifikues ligjor për burimin e ligjshëm të krijimit të shumës së huas, subjekti deklaroi se burimi më i rëndësishëm i të ardhurave ka qenë veprimtaria në shitjen e fruta-perimeve me shumicë dhe pakicë, të siguruara nga shfrytëzimi i tokave arë në pronësi dhe bashkëpronësi, dhe e blerjes së tyre brenda dhe jashtë territorit të vendit, dhe se *nga komunikimet me huadhënësit, por edhe dijenisë për shkak të lidhjes së afërt të gjinisë, shuma e huas është krijuar prej tyre edhe si rrjedhojë e shfrytëzimit të pasurive të paluajtshme tokë arë, si në drejtim të shfrytëzimit me kultivimin e tyre, ashtu edhe në drejtim të shitjes së tyre, duke bashkëlidhur dokumentacion për tokat bujqësore, fitimin e pronësisë dhe shitjen e dy sipërfaqeve prej tyre.* Në parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ, subjekti nuk jep shpjegime lidhur me krijimin e shumës së huas. Sa më sipër, përkundrejt deklaramit shterues të huadhënësve sipas kërkesës së subjektit dhe nën përgjegjësinë e tyre ligjore, se shuma e huas është krijuar nga të ardhurat nga aktiviteti i shitjes së fruta-perimeve me shumicë dhe pakicë, deklarimet e subjektit gjatë hetimit administrativ, *se prej tyre i është thënë* për burime të tjera të tyre për krijimin e kësaj shume, mbeten deklarative.

20.4. Rezulton se deklarimet e subjektit në Komision, lidhur me burimin e krijimit të shumës së huas, deformojnë deklarimin e vetë huadhënësve, të cilët, duke qenë zotërues të të ardhurave të tyre, janë përcaktuesit në vetë të parë të atyre të ardhurave që janë vënë në dispozicion të huas, dhe zgjerimi prej subjektit i burimeve në funksion të justifikimit të mundësisë së tyre për të krijuar

ligjërisht huan e pretenduar se i është dhënë subjektit, vlerësohen se janë përpjekje për të paraqitur një panoramë financiare të pëlqyeshme në funksion të procesit të rivlerësimit. Në të njëjtën logjikë, trupi gjykues vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se mospërputhja mes *deklarimit të huadhënësve se shuma 1.000.000 lekë* është tërhequr nga banka, ndërkohë që prej dokumentacionit bankar rezulton se është tërhequr gjysma e saj, krijon në vetvete pamjaftueshmëri të provueshmërisë së burimit të krijimit të shumës së huas. Pretendimet e subjektit, si për këtë rast, ashtu edhe lidhur me të ardhurat nga shitja e tokave bujqësore se huadhënësit nuk mund të ngarkohen me përgjegjësi nëse nuk janë të saktë në dhënien e informacionit, duke qenë se ata nuk kanë pasur detyrim ligjor të mbajnë mend rrethanat, dhe është normale të gabosh për sa kanë kaluar 15 vjet nga dhënia e huas, vlerësohen të pabazuara. Në kuptim të ligjit të zbatueshëm, barra e provës i takon subjektit të rivlerësimit dhe sigurimi i informacionit dhe i dokumentacionit justifikues ligjor për të provuar atë që ajo deklaron është detyrim i saj. Pretendimi se barra e provës që i ngarkohet për shkak të informacionit që lidhet me persona të tjerë të lidhur, është më e vogël se barra e provës që lidhet me veprimet e saj, është i pabazuar. Dispozitat ligjore nuk bëjnë dallim lidhur me peshën e barrës së provës kur vjen fjala për provimin e burimeve të ligjshme, por janë institucionet e rivlerësimit që vlerësojnë rast pas rasti situatat që paraqiten, në të cilat mund të rezultojë që subjekti të ketë një barrë prove të çpropocionuar për sa i takon të ardhurave të personave të tjerë të lidhur. Kjo rrethanë do të kishte kuptim në rast se subjekti do të ishte korrekt në deklarimet e saj, do të kishte plotësuar saktë deklaratën *vetting* dhe ato periodike, pra, do të kishte përmbushur ajo vetë të gjitha detyrimet e saj nga procesi, dhe barra e provës për pasuritë e personave të tjerë të lidhur do të mbetej me peshën më të madhe dhe jashtë mundësive të saj për ta përmbushur. Në rastin konkret, elementi i parë që konstatohet që me deklaratën *vetting* është mungesa e deklarimeve të subjektit, zanafillë nga e cila marrin peshë dhe vlerësohen edhe aspektet e barrës së provës lidhur me personat e tjerë të lidhur.

20.5. Duke sjellë në vëmendje detyrimin kushtetues se: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive dhe të të ardhurave”*, trupi gjykues vlerëson të pabazuar pretendimet e subjektit për konsiderimin e të ardhurave nga shitja e tokës si burim i shumës së huas, bazuar në qëndrimin e Kolegjit: [...] *në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur... Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur[...]*²⁷. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Ajola Prençi, burimi i krijimit të shumës së dhënë hua i identifikuar prej vetë huadhënësve - të ardhura nga aktivitetit tregtar i shitjes së fruta-perimeve prej vitit 1992 - përjashton *a priori* përfshirjen e të ardhurave

²⁷ Vendimi i Kolegjit nr. 15/2019 (JR), që i përket subjektit D. Rr..

nga shitja e tokave bujqësore tre vjet përpara dhënies së huas, të cilat duket të jenë përdorur nga huadhënësit në funksion të këtij aktiviteti tregtar apo për qëllime të tjera, të cilat huadhënësit nuk i deklarojnë në deklaratën e tyre noteriale.

20.6. Lidhur me të ardhurat e huadhënësve nga aktiviteti i shitjes së fruta-perimeve prej Xh. Th., subjekti pretendon se përderisa sigurimi i dokumentacionit nuk është bërë i mundur, pavarësisht vullnetit dhe përpjekjeve të saj për ta siguruar, Komisioni duhet të konsideronte parashikimet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Sipas subjektit, për sa prej Komisionit pranohet ushtrimi i këtij aktiviteti, krijimi dhe realizimi i të ardhurave deri në vitin 2000, duhej të pranoheshin si të ligjshme edhe të ardhurat nga aktiviteti tregtar për periudhën 2000 - 2004, për të cilin ekzistojnë indicie shtesë për zgjerimin e tij. Në ankim, në formë tabelore, subjekti i pretendon të ardhurat e huadhënësit nga aktiviteti tregtar në masën 6.000.000 lekë, për periudhën 1998 - 2000 dhe në masën 8.000.000 lekë, për periudhën 2001- 2004. Në parashtrime, po në formë tabelore, subjekti i pretendon të ardhurat e huadhënësit nga aktiviteti tregtar për periudhën 2000 - 2004, në masën 1.600.000 lekë, sipas saj, bazuar kjo në një vlerë të të ardhurave të nxjerra sipas xhiros së statusit financiar të subjektit tatimor. Sipas argumenteve të subjektit në parashtrime, në bazë të parashikimeve të legjislacionit tatimor, shtetasi Xh. Th. ka krijuar detyrime tatimore të vazhdueshme dhe, nëse nuk do t'i shlyente ato, nuk mund të vijonte me ushtrimin e aktivitetit tregtar deri në vitin 2014 [sipas shkresës së DRTSh-së nr. {***} prot., datë 25.04.2014, është njoftuar për përfundimin e procedurave të kalimit në status pasiv të subjektit]. Duke referuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar²⁸, subjekti pretendoi *në ankim* se huadhënësit kanë pasur të ardhura të mjaftueshme, nga burime të ligjshme të aktivitetit tregtar - *në parashtrime* se, edhe pse prej saj nuk provohet volumi i të ardhurave nga aktiviteti tregtar i z. Xh. Th., të dhënat e rezultuara duhet të mbahen në konsideratë, minimalisht në drejtim të mbulimit të një pjesë të shpenzimeve për jetesë.

20.7. Nga aktet në fashikuj, për subjektin tregtar “Xh. Th.”, referuar dokumentacionit të paraqitur prej subjektit²⁹, por edhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ prej

²⁸ “Personat fizikë dhe juridikë, subjekte të taksës vendore mbi biznesin e vogël, sipas kuptimit të nenit 10 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, ‘Për sistemin e taksave vendore’, të cilët realizojnë një qarkullim vjetor jo më shumë se 8.000.000 lekë dhe jo më pak se 2.000.000 lekë, janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale.”

²⁹ Për të mbështetur pretendimin për të ardhura të huadhënësit X. Th. nga ushtrimi i aktivitetit tregtar të shitblerjes së fruta - perimeve subjekti ka depozituar:

- Certifikatë regjistrimi në organin tatimor me numër serie {***}, nga e cila rezulton se Xh. Th. (bashkëshorti i hallës) me vendimin nr. {***}, datë 01.02.2000, është regjistruar në Degën e Tatim-Taksave të Rrethit Shkodër, për aktivitetin si biznesi i vogël, me kod Fiskal {***}, me adresë: {***}, Komuna Rrethina, Shkodër. Për të vërtetuar faktin që bashkëshorti i hallës ka ushtruar aktivitet tregtar, është evidentuar dhe pronësia mbi automjetin tip fugon, me targë {***}, me kapacitet 2,4 tonë, i përdorur për ushtrimin e këtij aktiviteti.
- Kërkesën e z. Xh. Th., drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, me nr. {***} prot., datë 14.10.2021, me të cilën është kërkuar dokumentacioni tatimor për subjektin tregtar “Xh. Th.”, Person Fizik, me numër NIPT {***}, si dhe dokumentacionin tatimor për subjektin tregtar “Xh. Th.”, Biznes i vogël, me kod fiskal {***}.
- Përgjigja e DRT-së Shkodër, nr. {***} prot., datë 14.10.2021, e cila informon se subjekti Xh. Th. është regjistruar me vendim gjykatë nr. {***}, datë 02.03.2000, me kod fiskal {***} dhe me aktivitet “{***}”, shoqëruar me certifikatën e regjistrimit në organin tatimor, me numër serial {***}. Shkresa gjithashtu informon se sipas sistemit tatimor elektronik (SIT), që ka hyrë në fuqi në zbatim në vitin 2005 për regjistrimin e deklaratave tatimore, rezulton

Komisionit³⁰, nuk rezulton asnjë gjurmë dokumentare në lidhje me volumin e të ardhurave të krijuara nga ky aktivitet apo shlyerjen e detyrimeve tatimore. Në këto rrethana faktike dhe ligjore, ku institucionet përkatëse provojnë vetëm ekzistencën e dokumentacionit certifikues për ushtrimin e aktivitetit tregtar të huadhënësit Xh. Th., por jo qarkullimin apo të ardhura të fituara, trupi gjykues vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit se, në raport me kërkesat ligjore për provueshmërinë e burimit të ligjshëm, pretendimet e subjektit mbeten në nivel deklarativ. Në këtë kontekst, pretendimet e subjektit të mbështetura vetëm në rregullimet e kuadrit ligjor të zbatueshëm, si për pagim të detyrimeve tatimore prej z. Xh. Th., sikundër edhe ato për masën e fitimit të realizuar, mbeten të paprovuara dhe deklarative.

20.8. Subjekti pretendon kryerjen e analizës financiare për familjen Th., në funksion të sqarimit të plotë të gjendjes faktike për personat e tjerë të lidhur, rrjedhimisht edhe të mundësisë së dhënies së huas, sipas një qasje garantiste, që parandalon dëmtimin e subjektit të rivlerësimit në përputhje me parimin e objektivitetit, analizë e pakryer prej Komisionit, pasi mungon si në vendim, ashtu edhe në grupin e analizave financiare të dërguara me e-mail. Sipas subjektit, referuar analizës së bërë prej Komisionit në procesin e rivlerësimit të vëllait të saj, subjektit të rivlerësimit A. Y., për të njëjtët huadhënës, për të njëjtën shumë dhe thuajse në të njëjtën kohë, dhe sipas kësaj praktike për periudhën 11.12.2000 – 24.11.2004 [data e dhënies së huas], huadhënësit kanë pasur mundësi kursimi. Duke referuar qëndrime të Kolegjit³¹, subjekti shprehet se, nëse pas kryerjes së analizës financiare huadhënësit do të rezultojnë me balancë negative për krijimin në tërësi të shumës së huas, vlera e bilancit negativ nuk mund të përbëjë argument për moskonsiderimin në tërësi të shumës së huas, por në analizën e saj financiare duhet të përfshihet ajo shumë që justifikohet me burime të tyre të ligjshme financiare.

20.9. Duke risjellë në vëmendje sa analizuar në paragrafin 14.12, lidhur me trajtimin individual të çdo rasti, bazuar në rrethanat specifike të tij, nga konsultimi nga burime të hapura i vendimit të Komisionit për subjektin A. Y., i cili, për më tepër, nuk është i formës së prerë, në bazë të

*se nga të dhënat e C@ts të DRT Shkodër, rezulton si tatimpagues Xh.T., me NIPT {***} (regjistruar datë 26.03.2004) dhe aktivitet “{***}”, është me status pasiv që nga data 21.05.2014.*

³⁰Konkretisht:

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. {***} prot., datë 01.07.2021, informon se Xh. C. Th., i datëlindjes 20.05.1958, me nr. personal {***}, rezulton i regjistruar si person fizik me nr. Nipt {***} pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, me status pasiv nga data 21.05.2014, por nuk disponojnë të dhëna të sakta identifikuese që vërtetojnë përkatësinë me shtetasin në fjalë.
- QKB-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 28.06.2021, informon se Xh. C. Th. figuron i regjistruar me vendimin nr. {***}, datë 19.01.2001, të Gjykatës së Rrethit Shkodër, për të cilin nuk gjendet NUIS (NIPT); si dhe i regjistruar me vendimin nr. {***}, datë 02.03.2000, të Gjykatës së Rrethit Shkodër.
- DRT Shkodër, me shkresën nr. {***} prot., datë 04.05.2021, informon se në Arkivin e Drejtorisë nuk disponohen të dhëna dhe dokumentacion për Xh. C. Th., me kod fiskal {***}.
- Bashkia Shkodër, me shkresën nr. {***} prot., datë 03.08.2021, informon se Xh. C. Th. nuk është i regjistruar si biznes në regjistrat e taksapaguesve në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Shkodër, dhe prandaj nuk kanë informacion për këtë shtetas.
- Auto e tipit fugon, i blerë në datën 21.02.2000, në vlerën 1.500.000 lekë, është automjeti i regjistruar dhe në degën e Tatim-taksave të rrethit si vend i ushtrimit të aktivitetit autodyqan.

³¹ Subjekti referon vendimet e Kolegjit nr. 15/2023 (JR); nr. 15/2019 (JR); nr. 20/2019 (JR).

deklarimeve dhe dokumentacionit të depozituar prej tij, rezulton se është kryer analizë financiare për familjen Th. për periudhën 1999-2006, nga ku ka rezultuar pamundësi financiare prej (-) 1.708.274.85 lekësh. Përpos këtij rezultati, i cili, për më tepër, referon një periudhë kohore përtej datës 23.11.2004, që i korrespondon dhënies së huas subjektit, në të janë përfshirë edhe të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme (tokë), edhe ato nga shitja e tokës në vitin 2000, të cilat, siç u analizua më lart në këtë vendim, jo vetëm subjekti nuk i ka pretenduar në Komision e as në ankim, por as vetë huadhënësit nuk i kanë deklaruar si burim. Edhe në referim të një vlerësimi sipërfaqësor si ky që sapo u artikulua, trupi gjykues konstaton sërish situata faktike të ndryshme në dy proceset e rivlerësimit, ndonëse individët në analizë janë të njëjtë, të cilat e bëjnë të pamundur trajtimin dhe arritjen e një rezultati të njëjtë. Për gjithë sa më sipër, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit që analiza financiare për familjen Th., e kryer nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit A. Y., mund të përdoret në rastin e saj.

20.10. Për një qëndrim garantist ndaj pretendimeve të subjektit në lidhje me mundësinë financiare të huadhënësve për të justifikuar me burime të ligjshme shumën e huas, nga Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj u krye analiza financiare për familjen Th. për periudhën 2002 - 2004, duke konsideruar të ardhurat e përfituara nga shitja e tokës në vlerën 1.745.000 lekë. Nga kjo shumë e të ardhurave financiare të ligjshme, duke zbritur vlerën prej 1.478.640 lekë, për mbulimin e shpenzimeve të jetesës së familjes Th., të përbërë nga 5 persona, rezultoi diferencë pozitive prej 266.360 lekësh, një vlerë pothuaj e pakonsiderueshme për krijimin e shumës së huas prej 1.500.000 lekësh.

20.11. Për të gjitha sa u arsyetuan më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, *së pari*, nuk arriti të provonte ekzistencën e marrëdhënies së huas në vitin 2004, e cila rezultoi të jetë ekspozuar vetëm pas fillimit të procesit dhe u shoqërua me dyshime domethënëse, që vinin në diskutim vetë ekzistencën e saj, për sa kohë akte që provonin atë, u konstatuan me të meta të rëndësishme në pikëpamje të formës, por edhe të përmbajtjes. Në mbështetje të këtij dyshimi shkojnë edhe rrethanat e tjera që lidhen me mosdeklarimin e kësaj marrëdhënie në deklaratën *vetting* dhe në ato periodike, apo me zgjerimin e burimeve të pretenduara për krijimin e shumës së dhënë hua, përtej edhe atyre që deklarojnë vetë huadhënësit, si edhe përtej atyre që deklarën vetë subjekti në hetim dhe ankim. *Së dyti*, subjekti ka dështuar të provojë se huadhënësit kishin të ardhura të ligjshme nga aktiviteti i deklaruar prej vetë atyre për të financuar huan. Për këto arsye, trupi gjykues, ashtu si edhe Komisioni, konkludoi se shuma prej 1.500.000 lekësh, e deklaruar si e marrë hua, nuk do të përfshihet në analizën financiare të kryer për verifikimin e burimeve të subjektit për krijimin e pasurisë “Apartament”.

21. *Lidhur me konkluzionin e Komisionit se nuk ka deklaruar kursimet/gjendjen cash në vlerën 1.000.000 lekë, të disponuara nga bashkëshorti dhe të përdorura për krijimin e pasurisë*

21.1. Komisioni ka konstatuar mospërputhje në deklaratimet e subjektit për burimin e krijimit të pasurisë “Apartament”, pasi në deklaratën *vetting* ka deklaruar si burim, paratë e kursyera nga të ardhurat dhe kredinë, ndërsa gjatë hetimit deklarën kursime në shumën 1.000.000 lekë të

bashkëshortit dhe hua në shumën 1.500.000 lekë. Nga hetimi i kryer ka rezultuar se, në kundërshtim me ligjin, bashkëshorti i subjektit nuk e ka deklaruar shumën 1.000.000 lekë si gjendje *cash* në vitin 2003 dhe as në vitin 2004, kur është krijuar pasuria “Apartament”. Këtë shumë, subjekti e deklaroi si kursim të bashkëshortit në pyetësin nr. 1, me pretendimin për mosnjohje të ligjit në kohë për plotësimin siç duhet të deklarave periodike vjetore. Komisioni ka vlerësuar të pabazuar pretendimin e subjektit, në kontekst të qartësisë dhe konsistencës në kohë të ligjit nr. 9049/2003, lidhur me përfshirjen në pasuritë e deklarueshme edhe të vlerës së likuiditeteve *cash*, gjendjes së tyre deri në 31 dhjetor, në raport me deklarimin e mëparshëm për të njëjtën pasuri.

21.2. Subjekti e kundërshton si të pabazuar këtë konkluzion me pretendimin për keqinterpretim prej Komisionit të vlerës së kursimeve të padeklaruara të bashkëshortit, duke i përcaktuar në vlerën 1.000.000 lekë. Sipas saj, këto kursime përbëhen nga kursimet e bashkëshortit nga paga për vitin 2003, që minimalisht janë në shumën 547.406 lekë, të padeklaruara për shkak të mosnjohjes korrekte të ligjit dhe mënyrës formale të plotësimit të deklaratës prej bashkëshortit dhe nga kursimet nga paga për vitin 2004, të cilat u përdorën për blerjen e banesës këtë vit dhe nuk mund të konsiderohen të padeklaruara. Sikundër në Komision, subjekti pretendon se, pavarësisht të mosdeklarimit të kursimeve prej bashkëshortit në DIPP-në 2003, ato janë deklaruar në mënyrë të përgjithshme në deklaratën *vetting* [pa u specifikuar vlera për vitin 2003 dhe për vitin 2004] dhe, bazuar në këto rrethana, duhet të njihen si të ardhura të bashkëshortit për këtë vit deklarimi.

21.3. Nga aktet në fashikuj, trupi gjykues konstaton se në përgjigje të pyetësit nr. 1, subjekti deklaroi se apartamenti është blerë fillimisht nga një hua monetare nga të afërmit dhe nga kursimet e bashkëshortit, në shumën rreth 1.000.000 lekë deri në nëntor 2004, kursim që mund të nxirret nga analiza financiare e viteve 2002, 2003 dhe 2004. Subjekti deklaroi se ky kursim nuk është evidentuar në deklaratat periodike të pasurisë dhe në deklaratën *vetting*, për shkak të padijenisë dhe gabimit njerëzor në plotësimin e deklarave. Në parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ, subjekti shprehet se në analizën financiare të vitit 2004 nuk janë llogaritur si të ardhura kursimet e vitit 2003 të bashkëshortit, se në DIPP-në 2004 nga ana e bashkëshortit nuk janë deklaruar kursime, duke potencuar për gabime për shkak të vitit të parë të deklarimit, të provuara sipas saj nga gabimet në plotësimin e DIPP-së 2003.

21.4. Sa më sipër, trupi gjykues, *së pari*, konstaton se edhe për burimin tjetër të pasurisë “Apartament”, të deklaruar në deklaratën *vetting* - para të kursyera nga të ardhurat - gjatë hetimit administrativ, subjekti i pretendon vetëm si kursime të bashkëshortit në vlerën 1.000.000 lekë. *Së dyti*, ekzistenca e kursimeve të bashkëshortit mbetet e paprovuar në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016³², për sa nuk janë deklaruar në deklaratat periodike të pasurisë. Pretendimet për mosnjohje të ligjit/mënyrën formale të plotësimit të deklaratës së pasurisë, edhe në këtë rast, vlerësohen të pabazuara dhe si një mënyrë për të justifikuar mosprovueshmërinë e fakteve që duhet

³² “Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit”.

të kishin gjetur pasqyrim në këto deklarata. Nga këqyrja e DIPP-së 2003 të bashkëshortit të subjektit, konstatohen shënime³³ që tregojnë për mundësinë e dhënë për të korrigjuar deklaratën, rrethanë që tregon se personi i lidhur/bashkëshorti është asistuar në dorëzimin e deklaratës dhe mund të kishte deklaruar kursimet nëse ato do të ekzistonin vërtet. Për sa më sipër, pretendimet e subjektit që kundërshtojnë konkluzionin e Komisionit lidhur me shumën prej 1.000.000 lekësh, të pretenduar gjatë hetimit administrativ si kursime të bashkëshortit në vitet 2002 - 2004, vlerësohen nga trupi gjykues të pabazuara.

21.5. Mbështetur në konkluzionet lidhur me huan dhe kursimet e bashkëshortit si më sipër analizuar, trupi gjykues, pasi kontrolloi analizën financiare të Komisionit³⁴, konkludoi se subjekti dhe personi i lidhur gjenden në mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në vlerën (-) 1.054.115 lekë, në momentin e blerjes së kësaj pasurie dhe në vlerën (-) 1.327.330 lekë, në fund të vitit 2004. Për pasojë, trupi gjykues vlerëson që konkluzioni i Komisionit se subjekti gjendet në kushtet e parashikuara në germenat “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, është i drejtë, i bazuar në prova dhe në ligj.

22. *Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, me të cilat kundërshton si jo të drejta konkluzionet Komisionit për balanca negative në vlerën prej (-) 228.473 lekësh, për vitin 2011; në vlerën prej (-) 60.849 lekësh, për vitin 2012, dhe në vlerën prej (-) 12.561 lekësh, për vitin 2016, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:*

22.1. Komisioni, lidhur me analizën financiare të viteve 2011 dhe 2012, ka konkluduar se nuk qëndrojnë pretendimet e subjektit për të përfshirë vlerat monetare të përfituara nga dietat dhe bonusi i transportit për bashkëshortin, si të ardhura hyrëse në ekonominë familjare. Pretendimi se bashkëshorti nuk e ka konsumuar të gjithë vlerën e bonusit të transportit, bazuar në përlllogaritjet e një eksperti autoteknik, inxhinier mekanik, nuk është marrë në konsideratë prej Komisionit bazuar në praktikën e konsoliduar të Kolegjit³⁵, ku bonusi i transportit i dhënë nga punëdhënësi për të mbuluar një shpenzim të konsideruar të kryer nga subjekti, si i tillë i destinuar në funksion të ushtrimit të detyrës, për mbulimin e kostove të transportit të lidhura me ushtrimin e saj larg

³³ Marrësi në dorëzim i deklaratës [plotësuar me shkrim dore emër, mbiemër dhe nënshkrim], është shënuar në kuadratin “kthim për plotësim” me komentin “probleme në datat e deklaruara, u plotësua” e, më tej, është shënuar në kuadratin “në rregull dhe pranohet”.

³⁴ Në analizën financiare të kryer në Komision dhe në Kolegj, për periudhën janar 2004 - 24.11.2004, si dhe për të gjithë vitin 2004 janë konsideruar:

- Të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit në shumën totale prej 1.5466.723 lekë dhe 1.709.152 lekë (kjo e fundit për analizën që i përket gjithë vitit 2004);
- Shpenzime jetese në shumën 172.084 lekë dhe 187.728 lekë (kjo e fundit për analizën që i përket gjithë vitit 2004);
- Shpenzime ardhimi të konsideruara vetëm për analizën e vitit 2004, në shumën 400.000 lekë;
- Shpenzime për blerjen e apartamentit në shumën 2.450.000 lekë;
- Ndryshimi i likuiditeteve në shumën 1.246 lekë;

Rezultati financiar për periudhën janar 2004 – 24.11.2004 është në vlerën (-) 1.054.115 lekë;

Rezultati financiar për të gjithë vitin 2004 është në vlerën (-) 1.327.330 lekë.

³⁵ Vendimet e Kolegjit nr. 22, datë 16.09.2019; nr. 24, datë 30.09.2020; dhe nr. 12, datë 12.05.2021.

vendit të banimit, nuk mund të përfshihet si e ardhur. Komisioni konkludon se i njëjti qëndrim³⁶ vlen edhe për dietat, të cilat jepen me qëllim rimbursimin e shpenzimeve dhe jo për kursim.

22.2. Lidhur me analizën financiare të vitit 2016, e cila në përfundim të hetimit administrativ ka rezultuar me balancë negative prej (-) 120.561 lekësh, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit. Në analizë të pretendimeve të subjektit *se në analizën financiare të vitit 2016 është llogaritur fitimi neto, por nuk janë llogaritur shpenzimet për ushtrimin e profesionit të avokatit*, dokumentacionit të administruar, si dhe kërkesës për të njohur shpenzimet e avokatisë së bashkëshortit, të përfshira në DIPP-në e vitit 2016 ose në totalin e shpenzimeve për këtë vit të zbrësë këto shpenzime, Komisioni ka konkluduar të mos marrë në konsideratë pretendimin e subjektit, duke arsyetuar se: (i) subjekti ka deklaruar pothuajse në mënyrë të detajuar shpenzimet familjare, ndërsa nuk specifikon shpenzimet e aktivitetit të bashkëshortit, në profesionin e lirë të ushtruar prej tij si avokat; (ii) nuk është përmbushur detyrimi ligjor sipas legjislacionit të fushës, referuar Udhëzimit nr. 4095/2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, që ka rregulluar/normuar mënyrën e deklarimit të personave fizikë dhe juridikë si persona të lidhur me deklaruesin, sipas së cilit personi fizik (bashkëshorti i subjektit me cilësinë e avokatit), duhet të deklaronte saktësisht të gjitha të ardhurat, shpenzimet, detyrimet, pasuritë veçmas etj.

22.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e mësipërme të Komisionit, duke pretenduar se:

(i) Balancat negative për vitet 2011 dhe 2012 janë rrjedhojë e mospërfshirjes së pagesës së marrë prej bashkëshortit për shpenzime transporti [bonus] dhe dieta, por prej saj, me argumente dhe provën e paraqitur, konkretisht aktekspertimi teknik, i hartuar nga eksperti autoteknik/inxhinier mekanik H. M., vlerësuar në harmoni me të dhënat zyrtare për çmimin e karburantit për këto vite, ka provuar se nga bonusi i transportit janë kursyer shumë: 130.402 lekë në vitin 2011 dhe 81.168 lekë në vitin 2012. Lidhur me dietat e përfituara prej 135.000 lekësh në vitin 2011 dhe 147.000 lekësh në vitin 2012, subjekti pretendon ose të njihen si të ardhura të ligjshme ose nga shpenzimet për jetesë, sipas standardeve të ILDKPKI-së dhe INSTAT-it, të zbriten shpenzimet e transportit në vlerën e dietave.

(ii) Në analizën financiare të vitit 2016, shpenzimet e avokatisë të bashkëshortit duhet të zbriten nga shpenzimet familjare. Sipas subjektit, në DIPP-në 2016, në formularin e shpenzimeve të deklarueshme, është deklaruar vlera totale e shpenzimeve, duke përfshirë edhe shpenzimet e bashkëshortit për ushtrimin e veprimtarisë së avokatit, në vlerën 123.400 lekësh, që rezulton nga “Formulari i deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin”, të vitit 2016. Këto shpenzime nuk janë specifikuar më vete si rrjedhojë e vlerës më të vogël se 300.000 lekësh, mbi të cilën ligji nr. 9049/2003 parashikon detyrimin për deklarim.

³⁶ Vendimi i Kolegjit nr. 7, datë 05.04.2019.

22.4. Trupi gjykues, pas kontrollit të analizës financiare për vitet 2011, 2012 dhe 2016, bazuar në të dhënat e dokumentacionit të administruar, gjen të pabazuara pretendimet mbi disa zëra të analizës, duke konfirmuar në këtë mënyrë konkluzionin e arritur prej Komisionit se subjekti ka pasur pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për të krijuar pasuritë dhe përballuar shpenzimet për këto vite, situata që e vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e parashikuara në germën “b” të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, sipas analizës në vijim.

22.5. Në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit në jurisprudencën e tij, trupi gjykues rithekson se pagesa për transportin, sipas ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009, *“Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”*, ka mbuluar një shpenzim të destinuar dhe të kryer në funksion të ushtrimit të detyrës. Ndërkohë që sipas objektit të këtij ligji: *“Funksionarëve publikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë, në përmbushje të detyrimeve dhe të përgjegjësisve të ngarkuara nga detyra që kryejnë, shërbimi i transportit u mbulohet nga buxheti i institucioneve përkatëse”*, subjekti pretendon si shpenzime transporti të bashkëshortit, Drejtues Prokurorie, vetëm ato të transportit nga vendbanimi në vendin e punës, duke paraqitur aktekspertimin e përpiluar sipas kërkesës për *përlllogaritje të konsumit të karburantit për udhëtimin vajtje-ardhje, Shkodër-Pukë, mbi bazën e karakteristikave të automjetit*. Në këtë akt, përveç se kalkulohet e vetmja distancë e kryer, ajo mes vendit të punësimit dhe banimit, e cila edhe hipotetikisht nuk mund të konsiderohet se është e vetmja e kryer, nuk pasqyrohet ndonjë shpenzim për mirëmbajtjen e automjetit, konsideruar distancën mes destinacioneve 108 km, prej të cilave 64 km rrugë malore. Ndërsa Kolegji ka mbajtur një qëndrim të konsoliduar lidhur me këtë çështje në jurisprudencën e tij³⁷, përpjekjet e subjektit për të kundërshtuar këtë standard të vendosur, duken jobindëse dhe dëshmojnë në fakt për drejtësinë e qëndrimit të Kolegjit, përderisa në aktin që ajo paraqet për të provuar pretendimet për kursim, konstatohen defekte logjike, por edhe përdoren të dhëna vetëm të deklaruara dhe jo të provuara, në kushtet kur në asnjë mënyrë nuk mund të provohen as distancat e kryera në vite dhe as karburanti i shpenzuar për to, si edhe as ndonjë shpenzim eventual, që vjen nga konsumi i automjeteve apo i defekte të ndryshme që mund të kenë ndodhur.

22.6. Lidhur me pretendimin që dietat e përfituara nga bashkëshorti në vitet 2011 dhe 2012 të përshihen në analizën financiare të këtyre viteve, si të ardhura të ligjshme ose në shpenzimet për jetesë, sipas standardeve të ILDKPKI-së dhe INSTAT-it, të zbriten shpenzimet e transportit në vlerën e dietave, trupi gjykues vlerëson si vijon. *Së pari*, sipas qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit, të ardhurat e përfituara në formën e dietës janë konsideruar vlera monetare të destinuar për të mbuluar shpenzimet e kryera nga zyrtarët gjatë veprimtarisë së tyre, në funksion të përmbushjes së detyrës dhe, për rrjedhojë, ato nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim marrëdhënien e punës, sipas nenit 4 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, *“Për tatimin mbi të ardhurat”*, i ndryshuar³⁸. *Së dyti*, subjekti pretendon se mosllogaritja e dietave në analizën financiare sjell

³⁷ Shih vendimin e Kolegjit nr. 24, datë 30.09.2020.

³⁸ Shih vendimin e Kolegjit nr. 7, datë 05.04.2019.

rritjen e shpenzimeve për transport, pasi sipas standardeve të ILDKPKI-së dhe INSTAT-it shpenzimet për transport përbëjnë një zë të konsiderueshëm të shpenzimeve për jetesë. Duke sjellë në vëmendje se sipas INSTAT-it, shpenzimet e transportit përbëjnë vetëm rreth 7% të totalit të grupit të shpenzimeve për konsum joushqimor, që i korrespondon një vlere jo të konsiderueshme, siç pretendon subjekti e, për rrjedhojë, pa peshë në shpenzimet e jetesës për muajt kur janë përfituar dietat, trupi gjykues nga dokumentacioni i paraqitur konstaton se bashkëshorti i subjektit ka shkuar me shërbim në Tiranë dhe Durrës, duke u nisur nga qyteti i Pukës dhe duke mbërritur po në Pukë, në fund të shërbimit. Për rrjedhojë, edhe për ditët e shërbimit, nuk qëndron pretendimi i subjektit se shpenzimet e transportit llogariten dy herë, për sa për transportin Shkodër - Pukë dhe kthim, shpenzimet nuk përfshihen në dietat e përfituara.

22.7. Lidhur me pretendimet e subjektit se në DIPP-në 2016, në shpenzimet e deklaruara janë përfshirë edhe shpenzimet e bashkëshortit nga avokatia, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon. *Së pari*, në DIPP-në 2016, shpenzimet familjare janë deklaruar në shumën 1.713.029 lekë, të detajuar në zëra të ndryshëm [familjare, shkollë, kopsht, transport pune, shëndetësore, blerje automjeti etj.], pa cituar në këtë përshkrim shpenzimet e bashkëshortit nga avokatia. Për këtë konstatim, subjekti ka shpjeguar në Komision, si dhe potencon në ankim, se për të mos rënduar deklarin, këto shpenzime janë nënkuptuar me “etj.”. *Së dyti*, deklarimi i shpenzimeve familjare në mënyrë thuajse të detajuar, duke mos përfshirë në mënyrë të shprehur shpenzimet e bashkëshortit nga ushtrimi i profesionit si avokat, vjen në mospërmbushje të përcaktimeve të qarta dhe shteruese të dhëna në Udhëzimin nr. 4095/2016 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, në ndihmë dhe për zbatim prej subjekteve deklaruese. Konkretisht, sipas rregullimeve të aktit të sipërcituar për mënyrën e deklarimit të personave fizikë dhe juridikë si persona të lidhur me subjektin e rivlerësimit, personi fizik [aktiviteti avokat i bashkëshortit të subjektit] duhet të deklaronte saktësisht të gjitha të ardhurat, shpenzimet, detyrimet, pasuritë veçmas etj. Personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, sikundër ka deklaruar detyrimet tatimore dhe faturat e pashlyera nga klientët, duhej të kishte deklaruar edhe të ardhurat dhe shpenzimet nga ushtrimi i aktivitetit si avokat. Sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit për mospërmbushje të detyrimit ligjor dhe për balancë negative në vitin 2016, në vlerën (-) 120.561 lekësh.

22.8. Lidhur me analizën financiare të viteve 2011, 2012 dhe 2016, për shpenzimet e jetesës të familjes së saj me dy fëmijë të mitur, subjekti pretendon se shpenzimet për jetesë të saj dhe të bashkëshortit [madhorë] janë barazuar me shpenzimet e dy fëmijëve të mitur [vitlindje 2009 dhe 2012 (tutor)], të cilët kanë normë më të ulët të konsumit ushqimor dhe nuk kanë shpenzime të tjera [transport, komunikim, argëtim, restorante hoteleri etj.]. Bazuar në VKM-në nr. 870, datë 14.12.2011³⁹, subjekti pretendon se shpenzimet e një të mituri 5-18 vjeç janë 50% të një madhori dhe të të miturit 0-5 vjeç jo më shumë se 30% të një madhori.

22.9. Në aktin e referuar prej subjektit, të titulluar “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, nga vetë titulli, por edhe nga konsultimi i përmbajtjes, nuk

³⁹ Shih: <https://www.aac.gov.al/wp-content/uploads/2017/04/43.VENDIM-NR.870DATE-14.12.2011.pdf>

identifikohen parashikime për të mitur, të cilët logjikisht janë jashtë marrëdhënies së trajtuar me këtë akt. Përpos sa më sipër, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se shpenzimet e jetesës që përdoren nga institucionet e rivlerësimit në funksion të analizës financiare për subjektet e rivlerësimit, sipas standardit të ILDKPKI-së dhe INSTAT-it, përbëjnë një zgjedhje tejet garantiste, janë mesatare dhe përfshijnë të gjitha shtresat e popullsisë dhe zonat e Shqipërisë, që do të thotë se ato nuk mund të përfaqësojnë shpenzimet reale të çdo individi dhe familjeje. Në këtë kuptim, ato përbëjnë një vlerë mesatare që përfaqëson një jetesë normale të një njësie familjare, e cila është pranuar nga jurisprudenca e organeve të rivlerësimit si një standard ligjor i aplikueshëm për të gjithë subjektet dhe jo shpenzime që realisht janë kryer nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit për zvogëlimin e këtyre vlerave, u konsideruan të pabazuara.

22.10. Në përfundim të kësaj analize mbi shkaqet e ankimit, sërish subjekti i rivlerësimit rezulton me pamjaftueshmëri financiare për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve të jetesës, duke u gjendur para balancave negative në shumat (-) 1.327.330 lekë në vitin 2004; (-) 228.743 lekë në vitin 2011; (-) 60.849 lekë në vitin 2012; (-) 120.561 lekë në vitin 2016, situatë që kualifikohet sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

22.11. Përfundimet e arritura nga trupi gjykues, lidhur me problematikat e kriterit të vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, gerrat “a” dhe “b”, u vlerësuan si të mjaftueshme për të konkluduar se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm lidhur me këtë kriter, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, dhe se gjendet në kushte e një deklarami të pamjaftueshëm sipas pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

22.12. Pretendimet e subjektit se në rastin e saj duhej të zbatoheshin parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit nuk u gjetën të zbatueshme prej trupit gjykues, nën dritën e rrethanave që përcaktuan balancën negative, veçanërisht ato që lidhen me pasurinë “Apartament” dhe përpjekjet për të paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë dhe burimet e krijimit të saj, rrethana që pengojnë krijimin e besueshmërisë së subjektit në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë. Përveç kësaj situatë, trupi gjykues çmon të theksojë se zbatimi i këtyre parimeve nuk është një proces i veçantë dhe nuk mund të zbatohet në mënyrë të veçantë për secilin kriter, por ai duhet të përfshijë të gjithë procesin e rivlerësimit dhe të afektojë në këtë mënyrë zgjidhjen përfundimtare të dhënë për të. Në rastin objekt shqyrtimi, situata e mësipërme që lidhet me pasurinë do të duhej të vlerësohej krahas asaj që lidhet me kriterin e figurës për të konkluduar nëse parimi i proporcionalitetit do të mund të thirrej për zbatim.

Shqyrtimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kontrollin e figurës

- 23.** Bashkëshorti i subjektit, personi i lidhur P. P., rezulton të jetë dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit të Shkodër⁴⁰, për veprën penale të “Korrupsion pasiv të gjyqtarit, prokurorit

⁴⁰ Shih: [file:///C:/Users/User/Downloads/vend.mosk.20%6023 .pdf](file:///C:/Users/User/Downloads/vend.mosk.20%6023.pdf). Sipas vendimit të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese nr. 20, datë 03.02.2023, i cili ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, rezulton se bashkëshorti i subjektit, z. P. P., i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues individual me objekt shfuqizimin e vendimeve gjyqësore penale dhënë në ngarkim të tij, nr. {***}, datë 04.12.2015, të Gjykatës së Rrethit

dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga nenet 319/ç dhe 25 të Kodit Penal, dhe mbështetur në analizën e dispozitave që rregullojnë kontrollin e figurës, në nenin 3, pika 15, nenet 34-39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka konkluduar në përfundim të hetimit administrativ se subjekti kualifikohet si e papërshtatshme për vazhdimin e detyrës për shkak të dënimit të bashkëshortit të saj.

23.1. Lidhur me këtë çështje, Komisioni ka arsyetuar se: [...] *rëndësia që merr gjendja aktuale dhe faktike e çështjes, e ndodhur përpara një vendimi gjyqësor të formës së prerë (deri aktualisht), që e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar me burgim bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit (në kushtet e gjykimit të shkurtuar, kërkuar prej tij), për veprën penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, në bazë të neneve 319/ç dhe 25 të Kodit Penal, vepër e cila përfshihet në krimin e organizuar, siç përcaktohet nga pika 15, e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, si dhe detyra që ka pasur si prokuror dhe drejtues prokurorie, vlerësohen nga trupi gjykues për subjektin e rivlerësimit si rrethana që perceptohen negativisht në syrin e publikut dhe në kundërshtim me pritshmëritë dhe besueshmërinë e tij në figurën publike të një magjistrati, dhe si të tilla ato çmohen se cenojnë besimin e publikut, sipas pikës 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 [...].*

23.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vlerësimi i figurës së saj, duke e vlerësuar si një subjekt me kontakt të papërshtatshëm bazuar në marrëdhëniet martesore me shtetasin P. P., është antikushtetuese dhe rrjedhojë e interpretimit tërësisht të gabuar të ligjit nr. 84/2014. Subjekti pretendon se nuk ka cenuar detyrimet e këtij ligji, përderisa nuk ka asnjë parashikim/kufizim kushtetues dhe ligjor që detyron vënien në balancë të familjes me profesionin, dhe se perceptimi publik nuk mund të cenohet për shkak të marrëdhënieve familjare, duke argumentuar si vijon:

(i) Lidhur me kontaktin me shtetasin P. P., duhej analizuar në bazë të parashikimeve të pikës 6, neni 3 i ligjit nr. 84/2016⁴¹, për sa sipas këtij parashikimi, kontaktet e papërshtatshme janë vetëm ato që lidhen me ushtrimin e detyrës dhe ndikojnë në ushtrimin me korrektësi të saj. Në vështirësi të përmbajtjes së dispozitës, marrëdhëniet familjare nuk mund të konsiderohen “kontakt i papërshtatshëm”, për sa nuk janë vendosur dhe krijuar në mënyrë të qëllimshme për ushtrimin e detyrës, por janë krijuar për shkak të martesës, nuk ndikojnë në ushtrimin e detyrës prej saj. Në asnjë moment të jetës bashkëshortore, bashkëshorti nuk ka ndikuar dhe as do të ndikojë në punën e saj profesionale.

(ii) Bazuar në faktin se marrëdhënia me bashkëshortin nuk mund të konsiderohet “kontakt i papërshtatshëm”, nuk gjen zbatim pika 4 e nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, pasi pavarësisht se

*Gjyqësor Shkodër; nr. {***}, datë 23.09.2016, të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2022-964, datë 26.07.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Nga përmbajtja e vendimit, rezulton se bashkëshorti i subjektit në kohën e shqyrtimit të çështjes në Kolegj, është i dënuar edhe me vendim përfundimtar, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit ndaj vendimit nr. {***}, datë 23.09.2016, të Gjykatës së Apelit Shkodër për dënimin e tij.*

⁴¹ “Kontakt i papërshtatshëm është një takim, komunikim elektronik ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht nëse vendosen marrëdhënie biznesi, në kuptim të pikës 9 të këtij neni ose ndonjë marrëdhënie tjetër”.

bashkëshorti mund të kategorizohet sipas parashikimeve të pikës 15, të nenit 3, të këtij ligji, kusht për zbatimin e dispozitës është ekzistenca e “kontaktit të papërshtatshëm”.

(iii) Vlerësimi i Komisionit se: [...] *marrëdhënia bashkëshortore nuk hyn në kategorinë e marrëdhënieve të pashmangshme fisnore/me lidhje gjaku, por hyn në marrëdhënie familjare, që në këtë rast ka mbetur e qëndrueshme nga vetë zgjedhja që ka bërë subjekti* [...], është në kundërshtim të hapur me mbrojtjen e posaçme që i ofrohet familjes dhe martesës nga Kushtetuta dhe aktet ndërkombëtare. Qëndrimi në vijimin e marrëdhënies martesore, që në thelb lidhet me detyrimet e prindërimit të përbashkët, nuk e cenon figurën si prokurorë në aspektin kushtetues, përderisa në vështrim të parashikimeve të nenit A të Aneksit të Kushtetutës, nuk kufizohet “E drejta për martesë dhe familje”, parashikuar nga neni 53 i Kushtetutës, për shkak të procesit të rivlerësimit. Përveç se nga Kushtetuta, marrëdhëniet martesore dhe familja gëzojnë mbrojtje nga nenet 8 dhe 12 të KEDNj-së, si dhe nga “Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës”.

(iv) Lidhur me konstatimin se *nuk u vërejt ndonjë reagim i subjektit në kohën e ndodhisë së çështjes penale të bashkëshortit të saj*, subjekti shpjegon se prokurori nuk mund të bëjë deklarata publike për çështje personale, reagimi i vetëm është përmes punës, të përcjellë prej saj në 18 vite të ushtrimit të profesionit. Distancimi i saj me ngjarjen ka ndodhur, prej dy vitesh bashkëshorti është shkëputur nga sistemi i drejtësisë, rrugë e zgjedhur për të shmangur mundësinë e perceptimit publik për ndikim në punën e saj.

(v) Në shkelje të parimit të barazisë, nuk janë mbajtur në konsideratë vendimmarrje të Kolegjit dhe Komisionit, ku vlerësimi i figurës së subjektit të rivlerësimit nuk është ndikuar nga situata e lidhjeve familjare, si për shembull, rasti i trajtuar nga Kolegji në vendimin nr. {***}, datë 14.12.2020.

23.3. Në parashtrime, subjekti rithekson qëndrim e saj, *se marrëdhënia me shtetasin P. P. nuk është në kundërshtim me ushtrimin e detyrës prej saj*. Duke pretenduar pikësëpari detyrimin për të evidentuar dispozitën konkrete që lidhet me ushtrimin e detyrës, e që i ndalon vijimin e marrëdhënies martesore me bashkëshortin, më tej, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, që rregullon veprimtarinë/marrëdhënien e punësimit të magistratëve, subjekti pretendon se mbajtja e marrëdhënies martesore me shtetasin P. P., i cili është i afërm i saj për shkak të ligjit e po ashtu i rehabilituar, nuk konsiderohen si veprime që “*dëmtojnë rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor apo të prokurorisë*”.

23.4. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të pretendimeve dhe argumenteve në ankim dhe në parashtrime, e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit se marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me bashkëshortin, personin e lidhur P. P., person i përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikës 15, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, për shkak të një vendimi gjyqësor përfundimtar që e ka deklaruar atë fajtor për kryerjen e veprës penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, në bazë të neneve 319/ç dhe 25 të Kodit Penal, e vendos subjektin e rivlerësimit brenda përcaktimeve të neneve 38 e 39 të ligjit nr. 84/2016, të cilat përcaktojnë standardet dhe procedurat e kontrollit të figurës. Parë në këtë këndvështrim, pasja e

një marrëdhënie/kontakti të tillë, të konsoliduar, afatgjatë dhe të shoqëruar me interesa të përbashkëta të natyrave të ndryshme, në mungesë edhe të rrethanave lehtësuese të parashikuara nga neni 38, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në kuptim të dispozitave të mësipërme, vlerësohet se me të drejtë është konsideruar si një kontakt i papërshtatshëm për qëllime të këtij ligji. Në vijim, analiza e trupit gjykues.

23.5. Trupi gjykues, në funksion të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit, lidhur me konkluzionet e Komisionit për kriterin e kontrollit të figurës, evidentoi fillimisht disa çështje me natyrë ligjore, të cilat duhej të merrnin zgjidhje përpara se të analizoheshin pretendimet e shtrura nga subjekti, dhe që lidhen kryesisht me pasojat që prodhon penalizimi i saj disiplinor për shkak të dënimit të bashkëshortit.

23.6. Trupi gjykues vlerësoi se baza ligjore e analizueshme në këtë rast është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Aneksi i saj, si edhe ligji nr. 84/2016. Kuadri ligjor i propozuar për zbatim prej subjektit në ankim, si një alternativë ligjore e aplikueshme, u vlerësua nga trupi gjykues pa relevancë. Procesi i rivlerësimit është një proces i jashtëzakonshëm dhe që është parashikuar të kryhet vetëm një herë, i miratuar për shkak të problemeve endemike të korrupsionit të identifikuar prej faktorëve të brendshëm e të jashtëm në analizën e bërë për sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Në këtë kuptim, çdo rregull apo standard i vendosur prej tij, nuk mund të jetë analog apo i njëjtë me ato që vendos legjislacioni i juridiksionit të përgjithshëm, i miratuar me reformën në drejtësi dhe që prezumohet të jetë i zbatueshëm për të gjithë magistratët që e kanë kaluar filtrin e procesit të rivlerësimit, pra janë konsideruar të besueshëm në këndvështrimin e publikut dhe kanë hyrë në një regjim të zakonshëm kontrolli, tashmë nga struktura të reja, kontrolluese, si në aspektin administrativ, ashtu edhe në atë penal, edhe ato njësoj produkt i procesit të rivlerësimit dhe zbatimit të reformës në drejtësi. Në këtë kontekst, thirrja për zbatim e dispozitave të ligjit nr. 96/2016, i cili parashikon rregullat për shkeljet disiplinore të magistratëve sipas kontrollit të juridiksionit të përgjithshëm, është pa relevancë dhe nuk mund të përdoret si standard i zbatueshëm në procesin e rivlerësimit. Miratimi i nenit 103, paragrafi 1, shkronja “ç” e ligjit nr. 96/2016, nuk presupozon lënien pa fuqi apo shfuqizimin e dispozitave të ligjit nr. 84/2016, të cilat rregullojnë kontrollin e figurës në kontekstin e procesit të rivlerësimit dhe të cilat janë dukshëm më strikte se ato të kontrollit të zakonshëm. Ndërsa parashikimi i kësaj dispozite, sipas së cilës magjistrati konsiderohet se ka kryer shkelje disiplinore në rastin kur shoqërohet me persona të proceduar apo dënuar penalisht, përveç se *kur nuk kanë lidhje të ngushta gjaku ose ligjore me magjistratin*, neni 38, pika 4, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016, konsideron si rrethanë rënduese për konstatimin e kontaktit rastin kur *subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar*. Gjithashtu neni 38, pika 5, shkronja “b” e këtij ligji, e rendit distancën nga familjari i proceduar apo i dënuar si një rrethanë lehtësuese në drejtim të konstatimit të kontaktit të papërshtatshëm, duke parashikuar se *marrëdhënia familjare e subjektit të rivlerësimit me personin e përfshirë në krimin e organizuar është e largët ose ka kontakte familjare të rralla*. Me fjalë të tjera, nëse ligji nr. 96/2016 e konsideron marrëdhënien e gjakut ose të ligjit si një rrethanë që e përjashton magjistratin nga përgjegjësia disiplinore nga frekuentimi i personave me precedentë

penalë, ligji nr. 84/2016, jo vetëm se nuk e konsideron të tillë, pra përjashtues, por e vlerëson afërsinë e marrëdhënies, si kriter që përcakton konstatimin ose jo të kontaktit të papërshtatshëm. Analiza e mësipërme vlen për të evidentuar qartësisht se këto dy ligje përcaktojnë rregulla të ndryshme dhe në rastin e përplasjes mes normave, trupi gjykues sjell në vëmendje parimin e *lex specialis derogat legi generali*. Për pasojë, dispozitat që do të zbatohen në zgjidhjen e çështjes objekt shqyrtimi, janë ato të procesit të rivlerësimit, edhe pse në dukje mund të krijojnë një panoramë të një trajtimi të diferencuar mes magjistratëve, por që nuk vlerësohet si e tillë, përderisa legjislacionet janë përcaktuar të veprojnë në periudha kohore të ndryshme, sipas asaj që vetë ligjvënësi ka synuar të arrijë.

23.7. Të njëjtën filozofi dhe trajtim gjejmë në ligjin nr. 96/2016, edhe për sa i përket shkeljeve disiplinore të parashikuara si të lidhura me ushtrimin e funksionit, sipas parashikimeve të nenit 102 të ligjit, të cilat janë parashikuar në formë shteruese dhe janë të mirëpërcaktuara për magjistratët që ushtrojnë funksionet dhe duhet t'i njohin ato, për të shmangur një procedim disiplinor në ngarkim të tyre. Procesi i rivlerësimit, duke qenë një proces i jashtëzakonshëm, ka përcaktuar rregulla më të forta/strikte për të kontrolluar secilin kriter të procesit, si edhe një diskrecion më të gjerë të institucioneve të rivlerësimit për të përcaktuar nivelin e besueshëm për secilin prej tyre, në funksion të konfirmimit apo shkarkimit nga detyra të subjekteve të rivlerësimit. Për këto arsye, trupi gjykues mori në analizë çështjen objekt shqyrtimi, duke analizuar dhe interpretuar, sipas një interpretimi teleologjik, dispozitat kushtetuese dhe ligjore që lidhen me procesin e rivlerësimit për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Ajola Prençi.

23.8. Në vijim, trupi gjykues konfirmon se dënimi penal i bashkëshortit të subjektit, edhe ai magjistrat “prokuror”, në kohën e kryerjes së veprës penale, pavarësisht rehabilitimit të tij, e kualifikon atë në kategorinë e personave të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të pikës 15, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Neni Dh, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës parashikon se: *[...] kontrolli i figurës për lidhje me personat e përfshirë në krimin e organizuar bazohet në deklaratën për figurën dhe prova të tjera, përfshirë vendimet e gjykatave shqiptare ose të huaja,* ndërsa në pikën 2 të tij parashikohet se: *subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre, që mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklarimit, sipas ligjit.* Këto parashikime përcaktojnë zbatimin në kohë të dispozitave për kontrollin e figurës, deri para përpilimit të deklaratës për kontrollin e figurës, kohë në të cilën personi i lidhur plotëson të gjitha kushtet për përfshirjen në këtë kategori. Gjendja gjyqësore e bashkëshortit të subjektit pas përfundimit të periudhës së rehabilitimit nuk ndikon në vlerësimin e tij, sipas parashikimeve të pikës 15, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilave, i vetmi rast kur një individ i hetuar për veprat penale të parashikuara në ligjin nr. 10192/2009, mund të ndodhë të mos konsiderohet si i tillë, është *kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë.*

23.9. Analiza e mëpasshme e trupit gjykues lidhet me faktin nëse qenia e personit të lidhur si person i përfshirë në krimin e organizuar do të përbëjë një kontakt të papërshtatshëm për subjektin e

rivlerësimit në kuadër të parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Neni Dh, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës parashikon se: *Nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.* Nisur nga ky parashikim kushtetues, organet e rivlerësimit, duke konstatuar ekzistencën e kontaktit të papërshtatshëm, vijojnë më prezumimin e vendosjes së masës disiplinore, duke i kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën. Në këtë kontekst, për trupin gjykues u shtrua çështja, nëse është bashkëshorti i subjektit, si person i përfshirë në krimin e organizuar, një kontakt i papërshtatshëm, dhe nëse po, a ka provuar subjekti të kundërtën e prezumimit ligjor që përcakton vendosjen e masës disiplinore ndaj saj.

23.10. Në pikën 6, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, gjen vend definicioni i kontaktit të papërshtatshëm sipas parashikimit se: *“Kontakt i papërshtatshëm” është një takim, komunikim elektronik ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht nëse vendosen marrëdhënie biznesi, në kuptim të pikës 9 të këtij neni, ose ndonjë marrëdhënie tjetër.* Sipas këtij përcaktimi, kontakt i papërshtatshëm do të konsiderohet edhe vetëm një takim apo komunikim elektronik, edhe vendosja e një marrëdhënie biznesi apo çdo marrëdhënie tjetër që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës. Ky parashikim do të duhet të analizohet në harmoni me parashikimet e nenit 38 të këtij ligji, i cili përcakton procedurat dhe standardet që institucionet e rivlerësimit duhet të konsiderojnë për të konkluduar nëse ekziston një kontakt i papërshtatshëm i subjektit me një person të përfshirë në krimin e organizuar.

23.11. Pika 3 e nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, parashikon se: *Kontrolli i figurës përfshin vlerësimin e provave dhe informacioneve që lidhen me rrethanat që merren parasysh në konstatimet, sipas parashikimeve të pikave 4 dhe 6, të këtij neni, dhe rrethanat lehtësuese, sipas parashikimeve të pikave 5 dhe 7 të këtij neni. Vlerësimi duhet të përmbajë rrethanat që merren parasysh në konstatim, si dhe rrethanat lehtësuese të këtij konstatimi.* Sipas rregullit të parashikuar në këtë dispozitë, trupi gjykues vlerëson se procesi analitik që duhet kryer para se të deduktohet nëse një subjekt ka apo jo kontakt të papërshtatshëm, duhet të kalojë nëpër disa faza, të cilat plotësojnë dhe mbështesin njëra-tjetrën.

23.12. *Së pari*, duhet të ekzistojë një kontakt në format e parashikuara nga ligji me personin e përfshirë në krimin e organizuar. Në rastin konkret, nuk ka dyshime për ekzistencën e këtij kontakti, për sa kohë që subjekti dhe personi i përfshirë në krimin e organizuar janë të lidhur me martesë ligjore dhe bashkëjetojnë. Pra, eksiton marrëdhënia mes tyre, e cila duhet t’i nënshtrohet analizës nëse do të konsiderohet si e papërshtatshme në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Në kontekstin e kësaj analize, trupi gjykues mori në konsideratë disa rrethana në këndvështrim të parashikimeve ligjore, të cilat do të renditen më poshtë, që konsiderohen të rëndësishme për t’i dhënë përgjigje çështjes së shtruar për zgjidhje.

(i) Nuk rezulton që ligji nr. 84/2016 të ketë përjashtuar marrëdhëniet familjare si rrethana që të çojnë në kushtet e pasjes së një kontakti të papërshtatshëm. Përveç se nuk ekziston asnjë rregullim përjashtues, siç është arsyetuar edhe më lart, rezulton se subjektet janë të njohura që me plotësimin e deklaratës për kontrollin e figurës se lidhjet e tyre me familjarë të përfshirë në krimin e organizuar duhet të deklarohen dhe t'i nënshtrohen kontrollit lidhur me figurën e tyre. Në shtojcën nr. 3, të ligjit nr. 84/2016, në pjesën 5, të titulluar “Të dhëna për sigurinë”, në pikën b, shtrohet pyetja: “*A keni dijeni se një nga anëtarët e familjes suaj është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar*”, dhe në vijim vjen përshkrimi i termit “anëtar familje”, në të cilën përfshihet edhe bashkëshorti. Pyetja e drejtpërdrejtë për dijeninë, dhe jo për kontaktin, duke prezumuar se ai ekziston për shkak të marrëdhënies me anëtarë të familjes, ka vetëm një synim, vlerësimin e kësaj situate në drejtim të konkluzionit rreth kontrollit të figurës së subjektit.

(ii) Kjo pjesë e shtojcës vijon me pyetje rreth kontakteve me persona të përfshirë në krimin e organizuar, me subjektin dhe personat e lidhur me të, duke kërkuar përgjigje nëse ka kontakte me ta, të cilat duhen deklaruar e kontrolluar. Në analizën që i bëhet këtyre rregullave, konstatohet se ligjvënësi e ka konsideruar me rëndësi thelbësore për kontrollin e figurës, përfshirjen ose jo të anëtarëve të familjes në krimin e organizuar, qëllim krejtësisht i arsyeshëm, duke konsideruar faktin që sipas këtij ligji edhe një takim i vetëm me një individ të përfshirë në krimin e organizuar, mund të konsiderohet si kontakt i papërshtatshëm, nëse do të provohen rrethanat që shërbejnë për konstatimin e kontaktit, sipas parashikimit të nenit 38, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

(iii) Pyetjet e shtuara në shtojcën nr. 3, vlerësohen të lidhura me parashikimet e nenit 38, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, të cilat i japin edhe më shumë kuptim qasjes, se jo vetëm personat që kontaktohen për qëllime të papërshtatshme me detyrën dhe janë të përfshirë në krimin e organizuar, mund të përbëjnë kontakt të papërshtatshëm sipas ligjit, por edhe marrëdhënia me familjarët është pjesë e këtij vlerësimi, dhe mund të çojë në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme, për qëllime të këtij ligji që nuk lejojnë vijimin e detyrës.

(iv) Në nenin 38, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, përcaktohen rrethanat rënduese, të cilat, sipas pikës 3 të po këtij neni, i shërbejnë institucioneve të rivlerësimit, për të përcaktuar nëse ekziston kontakti i papërshtatshëm. Këto dispozita lexohen në optikën se në rast se do të ekzistonte një kontakt, takim, komunikim, marrëdhënie biznesi apo çdo marrëdhënie tjetër, që të konsiderohen që janë të papërshtatshme, duhet t'i nënshtrohen analizës së rrethanave që parashikon neni 38, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në këto rrethana, të cilat përshkruajnë mënyrën e kontaktimit të subjektit apo personit të lidhur me një person të përfshirë në krimin e organizuar, dhe që duhet të merren parasysh për të konstatuar kontaktin e papërshtatshëm, pra, për të thënë se marrëdhënia/kontakti/komunikimi, përbëjnë kontakt të papërshtatshëm, renditet edhe rrethana e germës “ç”, të pikës 4, të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës ekziston një kontakt i papërshtatshëm, nëse *subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar*. Ky parashikim, i parë lidhur me pyetjet e shtruara në shtojcën nr. 3, për anëtarët e familjes, si edhe në këndvështrim të renditjes në pikën 6, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, të çdo marrëdhënie, pa kufizim, që mund të vendosë dhe mund të jetë e vlefshme për t'u konsideruar si një kontakt i papërshtatshëm, çmohen se janë rregullime të këtij ligji për të përcaktuar si një objekt kontrolli nën optikën e kriterit të kontrollit

të figurës, edhe marrëdhëniet e subjektit me anëtarët e familjes, të tilla që mund të kualifikohen si kontakte të papërshtatshme.

(v) Në vijim të analizës së po kësaj dispozite dhe konkretisht të pikës 3, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues mori në shqyrtim nëse ekzistojnë rrethana lehtësuese, nga ato që parashikon pika 5 e po këtij neni, të cilat, gjithashtu, duhen analizuar për të konkluduar nëse ekziston apo jo kontakti i papërshtatshëm në kuptim të këtij ligji. Në analizë të shkronjave “a – dh”, të kësaj pike, rezulton se shkronjat “b” dhe “c” kanë relevancë me situatën në shqyrtim, duke qenë se të gjitha rrethanat e përshkruara si lehtësuese në pikat e tjera, duket se i referohen kontakteve që krijohen prej subjekteve për arsye të tjera që përcaktohen nga zgjedhje e tyre, dhe jo për shkak të marrëdhënies familjare, siç është rasti në shqyrtim. Në shkronjën “b”, të pikës 5, të këtij neni parashikohet se do të konsiderohet si rrethanë lehtësuese fakti nëse *marrëdhënia familjare e subjektit të rivlerësimit me personin e përfshirë në krimin e organizuar është e largët ose ka kontakte familjare të rralla*, rrethanë e cila nuk rezulton të jetë e mundur në rastin konkret, për shkak të natyrës së marrëdhënies që ka subjekti me personin e lidhur.

(vi) Gjithashtu, në konsideratë edhe të shkronjës “c” të kësaj pike, e cila parashikon se: *subjekti i rivlerësimit ka qenë i hapur, i besueshëm dhe i plotë në lidhje me kontaktet dhe është distancuar prej tyre. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me kohëzgjatjen e kontakteve ose me perceptimin e arsyeve të veprimeve të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit*, trupi gjykues konstaton se nuk gjenden sjellje të subjektit që të provojnë ekzistencën e kësaj rrethane. Pretendimet e subjektit se ajo ka reaguar sipas mënyrës dhe mundësisë së saj për të treguar distancimin prej ngjarjes, sepse nuk ka një distancim prej personit të lidhur, rezulton të jetë e pasinqertë, sepse vetë subjekti në ankim dhe parashtrime ka potencuar faktin që bashkëshorti i saj ka pretenduar se është i pafajshëm dhe se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore për t’u deklaruar si i tillë në proces, qëndrim që duket se është ndarë edhe prej vetë subjektit, përderisa ajo e sjell atë në vëmendje të trupit gjykues si për të relativizuar peshën e dënimit penal të bashkëshortit, si i pamërituar. Në këtë kuptim, veprimet e saj që ajo i prezanton për të provuar distancimin si, mosshoqërimi në seancat gjyqësore të zhvilluara për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të tij apo përkushtimi në punën e saj, *e para*, nuk duken të besueshme dhe të sinqerta, por në shërbim të ruajtjes së figurës publike dhe pozicionit si prokurore dhe, *e dyta*, nuk mund të shërbejë në këtë drejtim për sa kohë që ushtrimi me përgjegjësi i detyrës është detyrim për çdo magjistrat.

(vii) Për të gjitha arsyet e mësipërme, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka një kontakt të papërshtatshëm me personin e lidhur, në kuptim të nenit 3, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, duke qenë se nga kontrolli që u krye, sipas parashikimit të nenit 38 dhe verifikimit të rrethanave të parashikuara nga pikat 4 dhe 5 të këtij neni, ekzistojnë vetëm rrethanat rënduese sipas pikës 4, dhe asnjë prej atyre lehtësueseve sipas pikës 5. Trupi gjykues vlerëson se konkluzioni për pasjen e një kontakti të papërshtatshëm sipas kuptimit të ligjit nr. 84/2016 do të duhet të konsiderohet si një pasojë e drejtpërdrejtë e parashikimeve ligjore.

(viii) Pretendimet e subjektit se institucionet e rivlerësimit e kanë vënë atë në kushtet e cenimit të jetës familjare dhe të interesit më lartë të fëmijëve, sipas parashikimeve konventore dhe ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, dalin nga fusha e zbatimit të dispozitave

kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, që synon rivendosjen e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë dhe rimëkëmbjen e institucioneve të drejtësisë në vend. Detyrimet që u vijnë subjekteve prej këtij ligji nuk mund të shtrembërohen si ndërhyrje në jetën e tyre private apo me pasojë cenimin e saj, sipas neneve 8 dhe 12 të KEDNj-së, por ato lidhen me provueshmërinë e deklarimeve të tyre, të bëra në deklaratën *vetting* për ngjarje që kanë ndodhur para se ligji të hyjë në fuqi. Synimi i ligjit nr. 84/2016 është vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës e vlerësimi i aftësive profesionale të subjekteve, për periudhën e rivlerësimit që daton para hyrjes në fuqi të ligjit. Për pasojë, sjelljet e modifikuara të subjekteve pas hyrjes në fuqi të tij, dhe për t'i shpëtuar vendosjes së masës disiplinore, nuk mund të konsiderohen se janë të besueshme dhe as të vërteta, dhe as se vijnë nga një reagim mbi bazë integriteti i subjekteve, madje janë vlerësuar gjithmonë si të tilla, se janë kryer vetëm në shërbim të procesit të rivlerësimit, edhe në raport me kriterin e pasurisë, ku ato ndeshen rëndom. Në këtë kontekst, pretendimet e subjektit se ky ligj duket sikur e shtyn atë drejt dhënies fund të marrëdhënies martesore, në mënyrë që të konsiderohej se është distancuar prej veprimtarisë së bashkëshortit, vlerësohet prej trupit gjykues se do të ishte gjithsesi pa efekt, për sa kohë që subjekti do të duhet të demonstronte distancën me veprime të çdo lloji natyre, që jo domosdoshmërisht do të sillnin cenimin e jetës familjare, vullnetare dhe të atilla, që dëshmonin reflektim të sinqertë e të kryer pa pasur si shtysë nevojën për të përmirësuar situatën në procesin e rivlerësimit, që të mund të konsideroheshin të besueshme dhe të vlerësoheshin si rrethana lehtësuese. Këto sjellje/veprime si rregull, do të duhej të kishin ndodhur para se ligji të hynte në fuqi dhe jo të diktuar prej tij. Për pasojë, pretendimet se Komisioni me konkluzionin se ajo ka një kontakt të papërshtatshëm, për shkak të marrëdhënies me bashkëshortin e saj, ka cenuar jetën private dhe nenin 8 të Konventës, vlerësohen të papabazuara.

(ix) Përtej këtij argumenti, trupi gjykues vlerëson se në përmbushje të qëllimit të miratimit të reformës në drejtësi, atë të rikthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, qenia e subjektit si prokurore në detyrë, potencialisht e ngarkuar me ushtrimin e ndjekjes penale për veprat të ngjashme me ato për të cilat është deklaruar fajtor bashkëshorti i saj, do të ishte e papërshtatshme, edhe e parë në kontekstin e këtij procesi prej publikut, i cili analizon mënyrën sesi drejtësia kryen vetëkorrektimin. Për këtë arsye, trupi gjykues e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk mund të qëndrojë në detyrë për shkak të pasjes së kontaktit të papërshtatshëm, duke përfshirë cenimin e besimit të publikut si pjesë integrale e kualifikimit të situatës, sipas nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

23.13. Për pasojë, në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i arritur nga Komisioni, sipas parashikimeve të neneve 38 e 39 të ligjit nr. 84/2016, se subjekti i rivlerësimit vlerësohet i papërshtatshëm për vijimin e detyrës, në zbatim të pikës 2, të nenit 61 të këtij ligji, gjendet i drejtë dhe i bazuar në ligj.

- 24.** Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e kontrollit të figurës, në zbatim të pikave 1 dhe 5, të nenit D, të pikës 3, të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikave 2 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 470, datë

01.11.2021, që ka vendosur shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i drejtë dhe i bazuar në prova dhe në ligj.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 470, datë 01.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Ajola Prençi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 13.11.2024, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi